




# PARLAMENTI QË (S)DUAM

Bilanci parlamentar 2023. Gjetje dhe rekomandime



Raporti është realizuar nga Instituti i Studimeve Politike. Në funksion të monitorimit parlamentar 2016–2025 ISP ka ndërtuar platformën online [www.deputetim.al](http://www.deputetim.al).

Opinionet e shprehura në këtë studim janë përgjegjësi e stafit të ISP-së.

**Editor**

Afrim KRASNIQI

**Mbledhje dhe përpunimi i të dhënave**

Stafi i ekspertëve dhe monitoruesve të ISP-së

**Layout & design**

Frencis.Design

ISBN: 9789928475671

*Web: [www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)*

*E-mail: [contactaips@isp.com.al](mailto:contactaips@isp.com.al)*

*Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies*

*Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë*

# PARLAMENTI QË (S)DUAM

## **Bilanci parlamentar 2023. Gjetje dhe rekomandime**

Janar 2024

## PËRMBAJTJA

### AKRONIME

#### 1. HYRJE

1.1. NDRYSHIME NGA METODOLOGJIA E DERITANISHME

#### 2. GJETJET KRYESORE TË MONITORIMIT

#### 3. REKOMANDIME PRIORITARE

#### 4. BILANCI PARLAMENTAR DHE VENDIMMARRJA SI FORMALITET

4.1. PRESIDENTI, ROL KRITIK NË DEKRETIMIN E LIGJEVE

4.2. KONFLIKTUALITETI POLITIK DHE PËRGJEGJËSIA POLITIKE

4.3. QASJA E GABUAR E MAZHORANCËS PARLAMENTARE

4.4. QASJA E GABUAR E OPOZITËS PARLAMENTARE

#### 5. PROBLEMATIKA TË RËNDËSISHME TË AKTIVITETIT PARLAMENTAR

#### 6. VLERËSIMI I PËRFORMANCËS SË DEPUTETËVE DHE GRUPEVE

6.1. KLASIFIKIMI: DEPUTETËT MË EFIKASË NË PARLAMENT 2023

6.2. DEPUTETË ME 0 DISKUTIME GJATË SESIONIT PARLAMENTAR

6.3. KOMISIONET HETIMORE, PIKËNISJA E KONFLIKTIT POLITIK NË PARLAMENT

6.4. PËRJASHTIMET E DEPUTETËVE NË REKORDE HISTORIKE

#### 7. KUVENDI, TRANSPARENCA DHE PROBLEMATIKA

**ANEKS 1.** VENDET VAKANTE NË USHTRIMIN E FUNKSIONIT ZGJEDHOR NGA KUVENDI SHTATOR-DHJETOR 2023

**ANEKS 2.** ECURIA E SHQYRTIMIT TË PROJEKTLIGJEVE NË KUVEND GJATË PERIUDHËS SHTATOR-DHJETOR 2023

## AKRONIME DHE SHKURTIME

AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AP	Avokati i Popullit
ERRE	Enti Rregullator i Energjisë
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJKO	Gjykata e Krimeve të Rënda
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISKPKSH	Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri
ISP	Instituti i Studimeve Politike
KÇE	Komisioni për Çështjet Evropiane
KÇLAPDNJ	Komisioni për Çështjet Ligjore, Adm. Publike dhe të Drejtat e Njeriut
KDRTSH	Këshilli Drejtues i Radio Televizionit
KEF	Komisioni për Ekonominë dhe Financat
KEMIP	Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
KK	Komisioni i Konkurrencës
KLGG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
Komisionerët	Komisionerët e AP–së Komisionerët e Avokatit të Popullit
KPÇSSH	Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
KPJ	Komisioni për Politikën e Jashtme
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KRZGJ	Komisioni i Reformës Zgjedhore
KS	Kodi i Sjelljes së Deputetit
KSK	Komisioni për Sigurinë Kombëtare
KVPTM	Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
OSHC	Organizatrat e Shoqërisë Civile
PR	Presidenti i Republikës
SPAK	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit

## 1. HYRJE

Viti 2023 ishte i dyti në mandatin e tretë të Partisë Socialiste në qeveri, e cila e vetme, por e përforcuar edhe nga aleancë informale me PSD-në, vijon të ketë kontrollin e plotë numerik në parlament. E pa shqetësuar nga presioni publik (mungesë protestash dhe lëvizje antiqeveritare), si dhe nga raportet në përfaqësim (opozitë e dobët dhe e fragmentarizuar), si dhe e rikonfirmuar në zgjedhjet vendore të majit në shumicën absolute të bashkive, PS kishte të gjithë hapësirën, mjetet dhe mundësinë për të iniciuar reforma dhe për të jetësuar programin e saj qeverisës. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2023 pritej që institucioni i parlamentit, më i rëndësishmi në hierarkinë e sistemit qeverisës në Shqipëri, të kishte performancë të lartë, për shkak se ishte viti i parë i plotë pas hapjes së negociatave me BE dhe një vit kur Shqipëria do të ishte edhe aktor ndërkombëtar, duke qenë anëtare në Këshillin e Sigurimit, kryesore e radhës, si dhe mikpritëse e disa samiteve të rëndësishme politike, përfshirë ai i Procesit të Berlinit.

Të dhënat cilësore të bilancit politik 2023, sidomos të sesionit parlamentar të vjeshtës (shtator–dhjetor) dëshmojnë se ky vit, ndryshe nga pritshmëritë, përbën një shans të humbur për reforma dhe kthim pas në integritetin e institucioneve dhe maturisë politike.

- Parlamenti shënoi regres të dukshëm, përfshirë edhe dobësimin e rolit të vet në sistemin politik, si dhe heqjen dorë nga ushtrimi i disa përgjegjësiave thelbësore kushtetuese, përfshirë funksioni kontrollues dhe ai zgjedhor. Kriza politike e vjeshtës dhe konfliktualiteti politik e agravoji gjendjen deri në atë nivel sa për herë të parë gjatë tranzicionit parlamenti u bë vend i përplasjeve të vazhdueshme civile dhe seancat plenare funksionuan në kohën më të shkurtër të mundshme, ndofta ndër më të shkurtrat në historinë e parlamentarizmit.
- Kuvendi refuzoi të përmbushë detyrime të rëndësishme kushtetuese, përfshirë gjashtë vendime të Gjykatës Kushtetuese, si dhe vakancat e paarsyeshme të 23 zyrtarëve të lartë që duhej zgjedhur nga Kuvendi, midis të cilëve gjenden institucione që u ka skaduar afati ligjor prej më shumë se një viti. Kuvendi u investua në marrëdhëniet publike dhe bëri disa hapa pozitiv në drejtim të transparencës dokumentare, por nuk shënoi ndonjë akt të llogaridhënies dhe as të reflektimit dhe maturimit për rikthim në normalitet.
- Arroganca e mazhorancës së njësuar me pushtetin e personalizuar ekzekutiv, si dhe kriza e opozitës e ndihmuar nga mbivendosja e agjendave personale mbi atë kolektive politike

ishin tiparet identifikuese për dy palët kryesore politike, përgjegjëse kryesore për bilancin kritik të parlamentit. Nga ana tjetër, drejtuesit e Kuvendit, përfshirë kryetarja e Kuvendit, zv/kryetarët dhe drejtuesit e sekretariateve, dështuan të krijojnë një profil administrimi parlamentar në përputhje me Rregulloren dhe praktikën e mira parlamentare, si dhe u investuan edhe personalisht në dobësimin e rolit të Kuvendit dhe agravimin e konfliktualitetit apo rënies së standardeve aty.

Instituti i Studimeve Politike (ISP) vijon ta monitorojë Kuvendin dhe aktivitetin parlamentar prej vitit 2016. Në vitet 2016–2017 nisma u mbështet nga FES, periudha 2017–2020 nga ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta, periudha 2021–2022 nga ambasada e Zvicrës dhe prej 2023 me vetë kontributin e stafit të ISP-së. Gjithsesi, gjatë viteve të fundit ISP ka pasur dhe ka angazhime të tjera specifike lidhur me monitorimin e parlamentit, të tilla si, monitorimi i jetësimit të dekriminalizimit (mbështetur nga NED), monitorimi i standardeve të Kodit të Sjelljes dhe transparencës (mbështetur nga ambasada amerikane), si dhe monitorimi i procesit të raportimit dhe mbikëqyrjes së institucioneve të pavarura (mbështetur nga WFD/ambasada britanike). Si pjesë e angazhimit ISP publikon raporte profesionale monitorimi, të cilat gjenden në faqen zyrtare [www.isp.com.al](http://www.isp.com.al).

Ky raport nuk përfaqëson një projekt dhe as nuk ka donator specifik, ndaj të gjitha gjetjet dhe vlerësimet janë përgjegjësi e ISP dhe stafit të vet të ekspertëve dhe monitoruesve. Qëllimi ynë monitorues lidhet kryesisht me nevojën që ekspertiza jonë e krijuar prej kaq vitesh të përdoret pozitivisht në drejtim të informimit publik mbi parlamentin dhe aktivitetin parlamentar në Shqipëri, por edhe për shkak se vlerësojmë se nuk ka sens që organizatat e shoqërisë civile të operojnë më monitorime pjesore në sektorë të ndryshëm të qeverisjes dhe politikës duke lënë pa monitorim Kuvendin, institucionin kryesor në sistemin politik.

Raporti merr në analizë treguesit kryesore të parlamentit aktual, bilancin ligjvënës të sesionit parlamentar shtator–dhjetor 2023, ushtrimin e funksioneve kushtetuese të parlamentit, si dhe ofron gjetje dhe rekomandime. ISP në monitorimin e cilësisë së aktivitetit parlamentar, respektimit të parimeve të transparencës dhe të integritetit ka analizuar aktin bazë të organizimit dhe funksionimit të Kuvendit (Rregulloren), kornizën ligjore që drejton dimensionin e etikës dhe sjelljes parlamentare në Shqipëri (Kodin e Sjelljes së Deputetit dhe akte të brendshme), praktikën aktuale të zbatimit të kuadrit normativ gjatë zhvillimit të punimeve parlamentare në komisione dhe seancë plenare si dhe praktikën aktuale të zbatimit të standardeve të vendosura të etikës dhe integritetit parlamentar. Në kapitullin e dytë ISP paraqet disa problematika të shoqëruara me rekomandimet sugjeruese përkatëse të cilat do të rrisin cilësinë e aktivitetit parlamentar me standarde më të larta të punës si dhe do të garantojnë zhvillimin e mëtejshëm të standardeve të etikës dhe sjelljes parlamentare duke rritur besimin e publikut tek parlamenti.

ISP fton Kuvendin të pranojë dhe trajtojë raporte të tilla nga shoqëria civile, si kontribute plus për vetë deputetët dhe Kuvendin, standardet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Shqipëri. Stafi i ISP, ashtu si në të kaluarën edhe në të ardhmen është i gatshëm t'i përgjigjet pozitivisht çdo ftese dhe kërkesë të Kuvendit, grupeve parlamentare dhe strukturave administrative, lidhur me problematikat e trajtuara si dhe rekomandimet e ofruara. Interesi qytetar dhe publik është i njëjtë, Shqipëria meriton një parlament sa më efektiv, transparent e llogaridhënës, si dhe një shoqëri civile sa më profesionale, të pavarur dhe produktive.

### 1.1. NDRYSHIME NGA METODOLOGJIA E DERITANISHME

Objekt i monitorimit dhe këtij raporti është aktiviteti parlamentar i periudhës shtator–dhjetor 2023. Për shkak se në katër muaj aktivitet dy muaj opozita zgjodhi të mos jetë pjesë e aktivitetit normal parlamentar është teorikisht dhe praktikisht e pamundur të ruhet sistemi i vlerësimit të nivelit të angazhimit të deputetëve, klasifikim që ISP ka ofruar rregullisht prej vitit 2016 për të gjithë deputetët dhe të gjitha legjislaturat. Nëse i referohemi të dhëna të periudhës shtator–tetor stafi realizoi klasifikimin e përgjithshëm të deputetëve, ku dy deputetë të opozitës (Tabaku dhe Zhupa) rezultuan deputetët më efikasë, por nëse i shohim në kontekstin e katër muajve asnjë deputet i opozitës nuk bën pjesë në 20–30 deputetët më efikasë të parlamentit. Nga ana tjetër, deputetë të PS që kanë pasur angazhim mesatar, për shkak të mungesës së opozitës dhe mënyrës sesi u zhvilluan seancat dhe komisionet, kanë kuota mjaft të ulta, por të mjaftueshme për të qenë në krye të listës.

Për krahasim, nëse në legjislaturat e kaluara deputetët më efikasë mund të arrinin 75–85 nga 100 pikë në total, në rastin aktual asnjë prej deputetëve nuk ka arritur kuotat e 50 pikëve. Për tu kuptuar më qartë, – nëse deputetët vlerësoheshin për nismat ligjore, amendamentet në komisione, angazhimin në komisione apo diskutimet në seancat plenare, zhvillimi i mbi 60% të seancave vetëm disa minuta dhe pa diskutime apo zhvillimi i mbledhjeve të komisioneve online pa mundësi debati real, u ka pamundësuar deputetëve aktivë të shprehin aftësinë e tyre dhe për pasojë, ka pamundësuar një sistem të drejtë vlerësimi për ta.

Nga ana tjetër, në mungesë të hapësirës dhe mundësisë për aktivitet normal parlamentar, kryetarët e komisioneve kanë marrë apriori rol më të rëndësishëm sesa në praktikën normale parlamentare dhe se ata kanë përcaktuar edhe relatorët e ligjeve në komisione, duke imponuar një sistem angazhimi jo real dhe protokollar që nuk pasqyron efikasitetin dhe aftësinë reale të deputetëve. Rasti i një deputeti relator, i cili në diskutimet online në komision bëri skandal duke shfaqur sjellje jo etike dhe jo serioze në komunikim, është tipik tregues i caktimit të tyre jo mbi



bazën e aftësisë, por mbi bazën e nevojës formale për të pasur relator, ndërkohë që në traditën e komisioneve, relatorët në përgjithësi lexojnë materiale të gatshme të përgatitura nga stafi teknik mbështetës në komision, jo ndonjë produkt profesional apo politik të vetë atyre.

Një element tjetër i metodologjisë klasike që kemi përdorur në vite në vlerësimin e nivelit të angazhimit dhe efikasitetit të deputetëve lidhet edhe me vlerësimet negative në rast penalizimi disiplinor të deputetëve. Në rastin aktual aplikimi i këtij kriteri ka qenë i pamundur, për shkak të numrit të lartë të deputetëve të penalizuar dhe krijimit të bindjes se sidomos në rastet e përjashtimeve kolektive (23 deputetë në një rast të vetëm), nuk mund të kemi fajësi të njëjta dhe as ndëshkim të njëjtë. Sekretariati i Etikës duhej të kishte prova bindëse për secilin nga 23 deputetët dhe procedura duhej të ishte e hapur, me të drejtën e tyre për tu mbrojtur, dy kriterë që nuk janë respektuar. Për pasojë, stafi i ISP vlerëson se treguesi i masave disiplinore nuk mund të ishte pjesë e vlerësimit në sesionin e kaluar parlamentar.

Disa funksione dhe aspekte të tjera të aktivitetit parlamentar, si p.sh., numri i kërkesave drejtuar institucioneve apo numri i interpelancave, etj, gjithashtu nuk mund të aplikohet si kriter vlerësues në kohën kur nuk ka pasur seanca normale parlamentar dhe as respektim të procedurave në aktivitetin parlamentar. Edhe elementi i votës së deputetëve, pra pjesëmarrja në votimin e akteve, mbetet evaziv, i pa identifikueshëm dhe i pamundur të përfshihej si kriter vlerësimi. Nga monitorimi i stafit të ISP në asnjë rast të votimit të hapur gjatë seancave të periudhës 30 tetor – 21 dhjetor nuk ka pasur realisht numërim të votave, por deklaram nga drejtuesi i seancës i një rezultati formal, bazuar kryesisht në numrin e deputetëve të PS dhe të PSD të pranishëm në sallë. Madje në një rast specifikim, kryetarja e Kuvendit theksoi me zë një numër votash pro shumë më të madhe sesa numri i deputetëve prezent në seancë. Sipas Rregullores në raste të tilla votimi përsëritet, por në rastin në fjalë Kuvendi u mjaftua me korrektimin e numrit në njoftimin zyrtar për vendimmarrjen e seancës!

E fundi, por e rëndësishme për saktësim, stafi i ekspertëve të ISP vendosi të mos konsiderojë fjalë parlamentare kërkesat dhe ndërhyrjet e deputetëve për procedurë, pasi nuk kanë thelb diskutimi dhe as replikat 1–2 minutëshe personale që nuk kanë lidhje me agjendën parlamentare dhe as aktivitetin parlamentar.

ISP bashkëpunoi me Kuvendin në disa nisma që lidhen me rritjen e standardeve të transparencës, mbikëqyrjes dhe llogaridhënies, – rreth 15 deputetë nga i gjithë spektri politik u bënë pjesë aktive e aktiviteteve tona, një tregues vlerësimi, por edhe përgjegjshmërie e deputetëve të veçantë, të cilët ndonëse në qasjen e tyre konstruktive mbeten minorancë ndaj shumicës pa interes përfshirjeje dhe kontributi, përbëjnë shembuj pozitiv dhe një bazë e mirë solide për reformimin dhe forcimin e konceptit të parlamentarizmit në Shqipëri.

Në zhvillimet pozitive mund të përmenden gjithashtu disa akte të stafit administrativ të Kuvendit, si për shembull, pjesëmarrja e tyre aktive dhe konstruktive në aktivitete konsultimi me institucionet e pavarura lidhur me vlerësimin e mekanizmave të raportimit, në diskutime institucionale lidhur me standardet e informimit dhe llogaridhënies, në nisma për jetësimin e procesit të screening dhe të *kontrollit post-legjislativ*, etj. Disa seanca dëgjimore ishin publike dhe përmbajtësore, si dhe në tërësi përfaqësimi parlamentar në nisma të ndryshme rajonale ishte tregues pozitiv.

Gjatë sesionit të ri parlamentar 2024 ISP shpreson që Kuvendi të rikthehet në normalitet dhe monitorimi të vijojë sipas praktikës së ndjekur në vite, bazuar në 10 treguesit e cilësisë së aktivitetit parlamentar. Kjo do të ishte në dobi të vetë parlamentit, të deputetëve, të grupeve parlamentare, por sidomos edhe të zgjedhësve, medias dhe qytetarëve, të cilët duhet ta dinë se sa efektivë janë deputetët që zyrtarisht i përfaqësojnë ata në parlament.

## 2. GJETJET KRYESORE TË MONITORIMIT

Kuvendi si organi përfaqësues i popullit, në veprimtarinë që lidhet me funksionin e tij ligjvënës (miratimi i ligjeve dhe plotësimi i kuadrit kushtetues dhe ligjor të nevojshëm për funksionimin demokratik të shtetit dhe jetës shoqërore); me funksionin e tij zgjedhës (zgjedhja e disa prej funksionarëve më të lartë të shtetit); si dhe me funksionin e kontrollit dhe mbikëqyrjes (kërkesën e llogarisë ndaj institucioneve publike duke respektuar parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve), duhet të udhëhiqet nga parimet kryesore të shtetit të së drejtës dhe respektimi i standardeve të etikës, sjelljes dhe transparencës. Nga vlerësimi i përgjithshëm i stafit monitorues të ISP-së rezulton se gjatë sesionit parlamentar shtator – dhjetor 2023:

- I. Sesioni u dominua nga konfliktualiteti politik dhe incidentet e shumta, dobësim i dukshëm i dukshëmi aktivitetit parlamentar dhe rolit të parlamentit në sistemin politik, kufizim të lirive politike të deputetëve dhe keqpërdorim i përfaqësimit në funksion të agjendave personale politike. Rreth 50% e aktivitetit parlamentar ishte formal, me një mazhorancë që miraton akte ligjore pa debat dhe një opozitë që tenton të pengojë fizikisht dhe me mjete joparlamentare funksionimin e Kuvendit. Seancat plenare shënuan rekord historik për minutazhin minimal, vetëm në 8 minuta u votua edhe buxheti i shtetit 2024 dhe mesatarisht një ligj/vendim kaloi çdo 2 minuta seancë plenare.
- II. Kuvendi nuk miratoi asnjë reformë të rëndësishme gjatë sesionit të vjeshtës. Aktet e miratuara janë kryesisht në funksion të agjendës ditore dhe nevojave të Këshillit të Ministrave, i cili ishte iniciues i 100% të ligjeve të miratuara. Nismat e deputetëve janë rritur ndjeshëm, por komisionet e përhershme nuk janë angazhuar në shqyrtimin e tyre duke i lënë në harresë prej muajsh të tërë. Disa nisma u rrëzuan në seancë plenare, një sinjal dekurajues për deputetët në ushtrimin më të madh të së drejtës ligjvënëse. Jo të gjitha nismat ligjore të propozuara nga deputetët i nënshtrohen konsultimit publik. Në rastet kur procesi kryhet, publikohet vetëm nisma ligjore pa përfshirë ligjin e përditësuar për të cilin propozohen ndryshime. Mungesa e këtij të fundit sjell vështirësi në të kuptuarin e ndryshimeve të propozuara.
- III. Deputetët më aktivë dhe me bilanc pozitiv në parlament ishin Tabaku e Zhupa (PD), Brace e Bushka (PS). Gratë deputete patën efikasitet më të lartë sesa gjinia tjetër. Në total 41 deputetë nuk patën asnjë diskutim dhe rreth 30 deputetë nuk dëshmuan ndonjë kontribut real në komisione ose në seancat plenare. Në Kuvend vijon të mbingarkohet me angazhime një pakicë deputetësh ndërkohë që pjesa e madhe e deputetëve kanë aktivitet formal.

- IV. Kuvendi nuk shënoi progres në funksionin kushtetues të kontrollit mbi pushtetin ekzekutiv. Numri i shfrytëzimit të mekanizmave kushtetues dhe atyre të parashikuara me Rregullore (interpelancë, pyetje, mocion me debat, kërkesa për informacion) ishte i ulët. Shumica parlamentare rrëzoi kërkesat e pakicës për ngritje të dy komisioneve hetimore me arsyetimin se objekti dhe fusha e veprimit nuk respektojnë standardet dhe parimet kushtetuese, ndërkohë që nuk pati asnjë përpjekje nga ky krah politik për të propozuar formulime alternative dhe për t'i dhënë mundësinë pakicës që të riformulonte kërkesën e saj, sikurse vlerëson Gjykata Kushtetuese (GJK).
- V. Kuvendi nuk përmbushi funksionin e vet zgjedhor, duke krijuar 23 vakanca, përfshirë vakancën për Avokatin e Popullit dhe Komisionerin kundër Diskriminimit, dy institucione me rëndësi në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Mosrespektimi i afateve nga organet e përfshira në procesin zgjedhës/emërues ndikon negativisht në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e vetë institucionit, pavarësisht se ligjet organike garantojnë vazhdimësinë institucionale duke lënë hapësirë për qëndrimin në detyrë të anëtarit të organit deri sa të zëvendësohet. Rastet e dorëheqjeve apo shkarkimit nga detyra krijojnë boshllëk institucional. Në disa raste vazhdimësia garantohej vetëm për tre muaj. Po ashtu, Kuvendi nuk arriti të marrë vendim për rotacionin nga shoqëria civile dhe grupet e interesit në organet e rëndësishme të qeverisjes së drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, – shenjë kritike që mund të lexohet edhe si pakt i heshtur për të shtyrë mandatet aktuale të zyrtarëve me mandat të përfunduar në këto organe.
- VI. Kuvendi ka bërë hapa pas në drejtim të jetësimit të standardeve të parandalimit të konfliktit të interesit dhe të integritetit në aktivitetin e deputetëve. ISP adresoi në Kuvend të paktën një rast dokumentuar të konfliktit të interesit, ndërkohë që gjatë legjislaturës u shënuan disa raste të ligjeve “të porositura”. Për shembull, në dhjetor një drejtues institucioni të pavarur konfirmoi publikisht se nisma ligjore për ndryshimin e një ligji në favor dhe interes të tij personal ishte shkruar nga ai vetë, ndonëse formalisht nisma u paraqit në Kuvend në emër të dy deputetëve të mazhorancës.
- VII. Kuvendi nuk u investua dhe dëshmoi as vullnet politik e institucional për zgjidhje e reflektimi ligjor të së paku gjashtë vendimeve të Gjykatës Kushtetuese (lidhur me dispozitat në Kodin e Procedurës Civile, me pagat dhe pensionet suplementare, avokatët/aksidentet rrugore, vota e diasporës, dispozitat gjatë pandemisë, si dhe mandatii ish ministres së jashtme).
- VIII. Nismat e veçuara ligjvënëse të deputetëve, përjashtuar ato për buxhetin, u dominuan jo nga përpjekje për të iniciuar reforma apo për të zgjidhur problematika të qeverisjes, por

kryesisht për nevoja politike ditore dhe kundër rivalëve politikë. Të tilla ishin edhe nisma për ndryshime në ligjin për komisionet hetimore dhe nisma për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit.

- IX. Gjatë sesionit Kuvendi vendosi heqjen e imunitetit parlamentar për deputetin S.B, një prej 2–3 figurave politike dominuese të tranzicionit 32 vjeçar. Zoti Berisha është nën hetime nga SPAK. Megjithëse rreth një dekadë më parë ai ishte një prej iniciuesve të heqjes së plotë të imunitetit parlamentar në rastet e hetimeve për korrupsion, në rastin e tij pati qasje të kundërt. Kërkesa e SPAK dhe vendimi pasues i GJKO për të ndaluar lirinë e lëvizjes jashtë vendit dhe sekuestruar dokumentet e udhëtimit për deputetin S.B. përbën një rast tipik të konfliktit midis dispozitave ligjore dhe atyre kushtetuese. Deputeti refuzoi organet e drejtësisë duke bërë vetë–interpretimin e Kushtetutës, por një padi në Gjykatën Kushtetuese lidhur me këtë rast rezultoi në rrëzimin e saj dhe indirekt, në lënien në fuqi të praktikës aktuale.
- X. Deputeti A.A. vijoi të ushtrojë funksionin parlamentar, ndonëse prej korrikut është në kërkim ndërkombëtar i akuzuar për korrupsion. Kuvendi nuk kishte mekanizma trajtimi të praktikave të tilla dhe në kontrast me standardet e dekriminalizimit dhe integritetit, partia politike refuzoi ta përjashtojë atë edhe nga grupi parlamentar.
- XI. Aktiviteti legjislativ u bazua edhe në rreth 120 mbledhje të komisioneve të Kuvendit, në diskutime për projekt–aktet dhe në seanca dëgjimore. Komisionet e përhershme u përballën me vështirësi për të funksionuar normalisht (për shkak të bllokimit opozitar mbledhjet u zhvilluan online), për të siguruar kuorumin e mbledhjeve dhe për të pasur rezultate efektive. Rreth 39 vendime të Kuvendit u morën në kundërshtim me procedurat parlamentare të përcaktuara në Rregullore, si dhe rreth 32% e mbledhjeve të komisioneve parlamentare u zhvilluan online, përmes një vendimi të pabazuar ligjor të ndërmarrë nga Kuvendi, vendim i cili siç rezultoi nga hetimi i ISP, ishte marrë pas “faktit të kryer”, pra pasi kishin filluar mbledhjet online. Votimi nga makina i deputetëve u bë trend në së paku 12 raste, përfshirë edhe në votimin për buxhetin e shtetit 2024.
- XII. Kuvendi vendosi rekord historik me 63 penalizime disiplinore ndaj deputetëve, ku përfshihen 55% e deputetëve të opozitës. Rastet e penalizimeve gjatë vitit 2023 shënojnë statistikë më të lartë sesa legjislaturat 2005. Niveli i zbatimit të rregullave etike dhe të sjelljes është i dobët dhe kjo evidentohet në mungesën e vullnetit politik për të siguruar zbatimin e standardeve të vendosura megjithëse standardet kanë një qasje të mirë menduar ndaj etikës duke u harmonizuar edhe me standardet ndërkombëtare. Kuvendi inicioi ndryshime të njëanshme në Rregullore dhe Sekretariati për Etikën mori vendime disiplinore kolektive të pabazuara në verifikime, fakte dhe proces të drejtë. Kryetarja e

Kuvendit, në disa raste, ka marrë masën disiplinore “Përjashtim nga seanca plenare” ndaj deputetëve të opozitës por në asnjërin prej këtyre rasteve masa e marrë nuk është formalizuar me aktin juridik konkret të përcaktuar me Rregulloren Kuvendi. Sekretariati për Procedurat, Votimin dhe Etikën në marrjen e masave disiplinore i është referuar llogaritjes së afatit me ditë kalendarike ndërkohë që dispozitat e Rregullores, konkretisht neni 65/2, pika 4 përcaktojnë llogaritjen me ditë pune. Kjo, ka shkaktuar përplasje midis mazhorancës dhe opozitës lidhur me mbarimin e afatit 10–ditor.

- XIII. Referuar dispozitave të Rregullores, autoriteti i Kuvendit dhe organeve të tij, për respektimin e rregullave të etikës në komunikim, shtrihet edhe ndaj Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarëve të Këshillit të Ministrave, drejtuesve/përfaqësuesve të institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj si dhe ndaj personave të tjerë të pranishëm në Kuvend, por nga të dhënat monitoruese rezulton se *parimi i trajtimit të barabartë* (ndërmjet deputetëve të të gjithë spektrit politik) nuk ka gjetur respektim. Në mjaft raste është konstatuar përdorimi i një gjuhe të pahijshme dhe jo parlamentare, fyese apo kërcënuese nga Kryeministri, ministra apo deputetë të mazhorancës, megjithatë nuk janë marrë masa penalizuese.
- XIV. Kuvendi injoroi me vetëdije disa procedura dhe rregulla të rëndësishme të aktivitetit parlamentar, duke sjellë vendime me procedurë të përsheptuar apo duke shkelur afatet ligjore në nismat e tjera, duke çeduar në dokumentacionin e akteve ligjore dhe konsultimin publik, si dhe duke injoruar pothuajse të gjithë praktikën e mekanizmit të shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve në seancë. Në asnjë nga seancat e periudhës 30 tetor – 21 dhjetor nuk pati numërim votash, por deklarim formal, duke marrë të mirëqena votat 100% pro të mazhorancës.
- XV. Stafi i ISP evidentoi disa raste kur drejtues të komisioneve parlamentare zhvilluan konsultime individuale në zyrat e tyre me drejtues të institucioneve dhe të grupeve të interesit, të pa protokolluara dhe të pa raportuara ato në dokumentacionin parlamentar. Praktika të tilla krijojnë dyshime mbi integritetin e vendimmarrjeve në parlament dhe ndikimet negative që mund të sjellin lobimet informale.

### 3. REKOMANDIME PRIORITARE

Kuvendi, për shkak të pozicionit kushtetues si organi përfaqësues i popullit, është institucioni kryesor politik në sistemet demokratike të qeverisjes dhe ky status kërkon vendosjen e standardeve të larta të profesionalizmit dhe integritetit për të përmbushur siç duhet misionin e tij kushtetues. Në këtë mision Kuvendi duhet të udhëhiqet gjithmonë nga Kushtetuta, Rregullorja, dhe aktet e tjera ligjore. Duke u nisur nga analiza e gjetjeve në këtë raport, Instituti i Studimeve Politike paraqet në vijim rekomandime të cilat synojnë të përmirësojnë cilësinë e aktivitetit parlamentar dhe të garantojnë zhvillimin e mëtejshëm të standardeve të etikës dhe sjelljes parlamentare të cilat për rrjedhojë do të rrisin besimin e publikut tek parlamenti.

- I. Kuvendi e ka jetike nevojën e rikthimit pozitën kushtetuese dhe në normalitet, duke respektuar përcaktimet Kushtetuese mbi përgjegjësitë dhe rolin e Kuvendit, përcaktimet në Rregullore për procedurat parlamentare dhe përcaktimet në Kodin e Sjelljes lidhur me etikën, konfliktin e interesit dhe sjelljen parlamentare. Rikthimi në normalitet nënkupton nevojën jetike për dialog institucional midis grupeve kryesore politike dhe vendimmarrje sa më konsensuale lidhur me kalendarin dhe agjendën parlamentare.
- II. Kuvendi duhet të ushtrojë në kohë dhe me cilësi funksionin e vet zgjedhor dhe të investohet për dhënien fund të praktikës, kur tejkalmi i afateve shoqërohet me shtyrje të afateve të institucioneve të zgjedhura nga Kuvendi. Mandatet kohore janë përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligje organike që të respektohen, jo të negociohen.
- III. Kriza e viteve të fundit nxjerr në pah nevojën e madhe të Kuvendit për të reformuar Rregulloren dhe aktet e brendshme rregullatore lidhur me identifikimin e grupeve parlamentare, të drejtës së deputetëve për të ndryshuar grupe dhe ndërtimin e raporteve koherente midis shumicave dhe pakicave në parlament. Legjislatura nuk mund të jetë peng i një rezultati zgjedhor të arritur mbi bazë koalicioni, duke lejuar çdo fillim sesioni identifikimin e palëve politike në parlament.
- IV. Kuvendi duhet të respektojë parimin kushtetues lidhur me komisionet hetimore. Kjo kërkon ndryshimin e qasjes parlamentare dhe proceduriale, miratimin parimor të nismave dhe negocimin lidhur me objektin dhe kalendarin teknik të punës së komisionevehetimore. Mazhoranca duhet të heqë dorë nga arroganca dhe refuzimi apriori i nismave për komisione hetimore, opozita duhet të ketë qasje konstruktive për fokusimin në komisione që realisht lidhen me objektivat e kontrollit parlamentar.
- V. Kuvendi ka nevojë të reformojë strukturën përfaqësuese, mënyrën sesi funksionojnë Konferenca e Kryetarëve dhe Byroja, si dhe mënyrën sesi trajtohen nismat ligjore të deputetëve, detyrimet për interpelanca dhe seanca pyetjesh, si dhe përfaqësimi në

komisione ad-hoc, duke siguruar gjithëpërfshirje, transparencë dhe llogaridhënie. Shërbimi i Seancës Plenare, si shërbimi përgjegjës në Kuvend për dhënien e asistencës teknike dhe juridike Kryetarit të Kuvendit dhe deputetëve gjatë zhvillimit të punimeve parlamentare në seancë plenare, duhet të ketë një qasje tjetër më profesionale si dhe më serioze dhe më të përgjegjshme mbi përgjegjësitë e tij gjatë zhvillimit të punimeve parlamentare në seancë plenare.

- VI. Kuvendi duhet të reformojë strukturat, sidomos Këshillin për Legjislacionin dhe Sekretariatet për Procedurat, Votimet dhe Etikën. I pari duhet të garantojë jetësimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe përmirësimet ligjore në rastet e mosmarrëveshjeve midis ligjeve, i dyti duhet të garantojë një proces të drejtë dhe të besueshëm vendimmarrjeje në respekt të parimeve të Kodit të Sjelljes dhe Rregullores. Sekretariati si organ përgjegjës i Kuvendit që ndjek dhe mbikëqyr veprimtarinë procedurale të Kuvendit në seancë plenare, mund dhe duhet të dokumentojë plotësisht dhe me transparencë procesin vendimmarrës në rastet e votimit me kartona.
- VII. Kuvendi të korrektojë qasjen individuale të drejtuesve të komisioneve duke dokumentuar, zyrtarizuar dhe institucionalizuar çdo konsultim të tyre me grupet e interesit dhe institucionet e pavarura, si dhe duke dokumentuar në arkivin parlamentar përmbajtjen e këtyre takimeve.
- VIII. Kuvendi duhet të përmirësojë ndjeshëm mekanizmat e raportimit parlamentar ndaj institucioneve të pavarura, duke luajtur realisht rol mbikëqyrës, por edhe kontrollues të zbatimit të ligjit, si dhe të evitohet në këto praktika shfaqjet e konfliktit të interesit, trajtimit preferencial apo leximit partiak të produktit të institucioneve nën raportim. Kuvendi ka të drejtën dhe detyrimin që t'ia nënshtrojë debatit parlamentar propozimet për në organet kushtetuese dhe/ose të krijuara me ligj. Diskutimet shërbejnë si një instrument që publiku të njohë më shumë kandidaturat e propozuara dhe të vlerësojë zgjedhjen ose jo të tyre në institucionin ku garojnë.
- IX. Nevoja për njësim të normave të legjislacionit dhe ndërhyrjeve për evitimin e çdo konflikti midis përcaktimeve kushtetuese dhe atyre ligjore përbën një prej rekomandimeve të rëndësishme adresuar Kuvendit. Praktika si ai i interpretimit të parimit kushtetues me legjislacionin penal, lidhur me lirinë, imunitetin dhe të drejtat e deputetit, duhen analizuar dhe trajtuar institucionalisht për shmangie të mosmarrëveshjeve dhe krizave të mundshme.
- X. Kuvendi duhet të vërë në dispozicion informacione të mjaftueshme për të mundësuar qytetarët që të gjykojnë lidhur me integritetin dhe ndershmërinë e deputetëve individualë. Kuvendi mund dhe duhet të krijojë një sistem transparent deklarimi,



verifikimi dhe publikimi të Regjistrit të Konfliktit të Interesit, Regjistrit të Dhuratave, dhe elementëve të tjerë të Kodit të Sjelljes, konform Udhëzuesit të Detajuar të Sjelljes në Kuvend (miratuar me vendim të Byrosë së Kuvendit) në mënyrë që të rrisë standardet e integritetit dhe besueshmërisë.

- XI. Kuvendi duhet të ketë një grup pune që mban shënim dhe ndjek jetësimin dhe zgjidhjen e çështjeve lokale që ngrenë deputetët, si dhe duhet të mbështesë praktikën që ministrii shtetit ose zv/kryeministri të raportojnë periodikisht në Kuvend për të gjitha problematikat e ngritura nga deputetët. Kjo do ta bënte parlamentin më funksional, debatin më me produktivitet dhe pozitën e deputetit më afër qytetarëve të zonës që përfaqëson.
- XII. Kuvendi mund dhe duhet të miratojë një ligj organik për institucionin e Presidentit të Republikës, që të konkretizojë kompetencat e përcaktuara nga Kushtetuta, të rregullojë mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet Presidentit dhe Kuvendit, pa përjashtuar dhe raportet e Presidentit me organet e tjera kushtetuese dhe shtetërore. Në këtë kuadër, Kuvendi ka të drejtën dhe detyrimin që t'ia nënshtrojë debatit parlamentar dekretet e Presidentit të Republikës për emërim dhe shkarkim ministri.
- XIII. Referuar kuadrit normativ Byroja e Kuvendit ka detyrimin e hartimit të raportit vjetor lidhur me rastet e shkeljes së Kodit të Sjelljes si dhe masat disiplinore të marra ndaj deputetëve për këto shkelje. Pavarësisht kësaj, ky parashikim ligjor nuk ka gjetur zbatim. Transparenca në procedurat e zbatimit të Kodit të Sjelljes është një indikator i efektivitetit të Kodit pasi tregon në detaje shkeljen e parlamentarit dhe sanksionin e aplikuar. Kjo transparencë rrit besimin e publikut tek parlamenti dhe promovon kulturën e llogaridhënies.
- XIV. Kuvendi duhet të vendosë standarde integriteti dhe transparence në hartimin e kalendarit parlamentar, rendit të ditës, dhe respektimit të afateve të arsyeshme duke evituar ndërhyrjet e “minutës së fundit” në rendin e ditës, formalizmin në procedurë dhe imponimin apriori të mendimit të pushtetit ekzekutiv. Kalendarit i Punimeve të Kuvendit, lidhur me parashikimin e çështjeve në seancat plenare, duhet të hartohet duke mbajtur në vëmendje afatin 7 ditor të parashikuar për raportet e komisioneve për shqyrtimin e projektligjeve<sup>1</sup>. Shqyrtimi i nismave ligjore sipas afateve dhe rregullave të parashikuara në Rregullore dhe akte të brendshme të Kuvendit ndihmon në cilësinë e legjislationit.

<sup>1</sup> Psh të paktën në dy seancat e para plenare të periudhës tre javore të përfshihen çështje për të cilat komisionet kanë përfunduar shqyrtimin e tyre.

- XV. Drejtuesi i seancës plenare mund dhe duhet të ushtrojë kompetencën e tij në dhënien e masës disiplinore në rastet kur deputeti voton në emër të një kolegu tjetër i cili nuk është pranishëm në sallë. Zbatimi i përcaktimit ligjor për një verifikim paraprak të kartave të votimit nga drejtuesi i seancës plenare shmang mundësinë e votimit për të tretët, garanton legjitimitetin e vendimmarrjes së Kuvendit dhe paraqet një pasqyrë të plotë dhe reale të procesit vendimmarrës në fletët e votimit. Organet përgjegjëse të Kuvendit duhet të aplikojnë masa disiplinore të njëjta për raste të njëjta, pavarësisht përkatësisë politike dhe pozitës së deputetit në Kuvend (kryeministër, ministër) duke vendosur gjithnjë prioritare etikën dhe parimet e sjelljes, si dhe interesin publik dhe vlerat e larta të parlamentarizmit.
- XVI. Kuvendi duhet të krijojë akses më të madh ndaj shoqërisë civile dhe medias, sidomos lidhur me rekomandimet dhe raportet që vijnë prej tyre, për të siguruar qasje më proaktive dhe për të marrë përfitim maksimal ndaj gjetjeve, kritikave, sugjerimeve dhe rekomandimeve konkrete. Shoqëria civile nuk ka detyrim të ketë adresime të tilla, por Kuvendi e ka nevojë jetike vetëvlerësimin e brendshëm, dhe në mungesë të tij, prurjet nga shoqëria civile janë investim plus për Kuvendin dhe deputetët, investim që meriton vëmendje, vlerësim dhe reagim konstruktiv.

#### 4. BILANCI PARLAMENTAR DHE VENDIMARRJA SI FORMALITET

Statistikisht Kuvendi shënoi numër të madh seancash plenare, por të dhënat cilësore të tyre e bëjnë sesionin një nga më kritikët në historinë e legjislativave të fundit. Numri i akteve është gjithashtu i lartë, por analiza e detajuar e tyre është gjithashtu larg standardeve të mira parlamentare. Rreth një e treta e akteve ishin vendimmarrje në funksion të nevojave ditore politike dhe më shumë se 70% e tyre kaluan përmes procedurave jo demokratike vendimmarrëse. Në total 16 ligje u miratuan me shumicë të thjeshtë, 18 me shumicë absolute dhe 3 ligje me shumicë të cilësuar.

	Seanca	Akte ligjore	Nisma të qeverisë
<b>Shtator</b>	3	26	100%
<b>Tetor</b>	4	7	100%
<b>Nëntor</b>	3	19	100%
<b>Dhjetor</b>	4	15	100%
	14	67	100%

Gjatë sesionit nuk pati mocione mosbesimi dhe as besimi, nuk pati jetësim të kërkesave për interpelanca, si dhe disa nisma ligjore të deputetëve u injoruan duke mos u përfshirë në kalendarin e rregullt parlamentar. Kuvendi nuk ndërmori asnjë hap institucional lidhur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për mandatin e deputetes Xhaçka dhe as për votën e diasporës apo çështjen e herësit në zgjedhje, si dhe nuk zhvilloi asnjë mbledhje të komisionit më të rëndësishëm në debatin politik, atij të reformës zgjedhore.

Sesioni parlamentar i vjeshtës u bë i pari në historinë tonë parlamentare, kur një deputet vijoi mandatin duke qenë në kërkim ndërkombëtar për krimin e korrupsionit, si dhe pas 1993 dhe 1998, e treta legjislativë që hoqi mandatin e kryetarit të grupit më të madh të opozitës, duke e shoqëruar atë me masat ligjore të arrestit.

Të dhënat statistikore të aktivitetit parlamentar dëshmojnë se gjatë periudhës 30 tetor dhe 21 dhjetor, në të cilën seancat plenare u bënë të shkurtuara për shkak të incidenteve të shumta fizike në parlament, – një vendim është marrë në vetëm 2.4 minuta, dhe se 8 seancat janë zhvilluar në vetëm 97 minuta. Statistikisht një seancë plenare ka kosto të lartë buxhetore (10–12 mijë euro) dhe zhvillimi i tyre në 4 ose 8 minuta e bën funksionin e deputetit profesionin më të paguar për minutë në Shqipëri.

Datat e seancave plenare	Minuta	Ligje/vendime
<b>21.12.2023</b>	8.44	6
14.12.2023	8.34	5
07.12.2023	7.42	4
04.12.2023	14.01	0
20.11.2023	4.52	5
09.11.2023	17.23	5
02.11.2023	22.01	14
30.10.2023	15.17	0
<b>Totali</b>	<b>97.14</b>	<b>39</b>
Mesatarja e kohës për 1 vendim	2.4 minuta	-

Në praktikat e mëparshme parlamentare seancat kishin një mesatare debati prej 2–4 orësh, si dhe ligjet merrnin diskutime të gjata, sidomos diskutimi për buxhetin. Në dhjetë vitet e fundit diskutimi për buxhetin ka zgjatur minimalisht një ditë kalendarike, pra rreth 16–20 orë duke u ndarë kryesisht në dy seanca diskutimi, kurse në dhjetor 2023 diskutimi dhe votimi zgjati vetëm 8 minuta, një rekord që nuk mund të gjendet në asnjë parlament bashkëkohor, madje as në periudhën përpara 1990, kur parlamenti ishte formal dhe vendimet grumbulloheshin për dy seanca në vit.

Mazhoranca ka të drejtë kur pretendon se situata në Kuvend ishte e jashtëzakonshme, për shkak të aksionit të opozitës për të bllokuar seancat, por nga ana tjetër mazhoranca gabohet kur deklaron se vendimet janë legjitime dhe në përputhje me Rregulloren dhe standardet parlamentare. Ajo kishte mekanizma të tjerë në dispozicion (në një rast të ngjashëm gjatë kohës kur PD ishte në pushtet dhe PS në protestë fizike në parlament, mazhoranca e atëhershme e zhvendosi seancën në sallën e kryesisë së Kuvendit), si dhe kishte kohë të mjaftueshme për të iniciuar dialog parlamentar me palët e tjera politike për gjetjen e zgjidhjeve sa më optimale. Mosmarrëveshjet politike për komisionet hetimore mund të zgjidheshin edhe duke pranuar (mazhoranca), që vendimmarrja në çdo rast t'i kalonte Gjykatës Kushtetuese, në kushtet kur ajo për qëllime afatshkurtra politike ishte e vendosur për refuzimin e tyre.

#### 4.1. PRESIDENTI, ROL KRITIK NË DEKRETIMIN E LIGJEVE

Një vlerësim kritik meriton edhe roli i Presidentit të Republikës, i cili dekretoi pa rikthim të gjitha aktet ligjore të miratuara pa procedurë të rregullt në parlament. Argumenti i zyrës së Presidentit, se kthimi i ligjeve bëhet vetëm kur ka shkelje të Kushtetutës, është relativ dhe nuk bind, për shkak se nuk është Presidenti por Gjykata Kushtetuese organi që përcakton përputhshmërinë kushtetuese të një akti, dhe se Presidenti ka përgjegjësinë kushtetuese për te dekretuar vetëm akte që plotësojnë të gjithë parametrat ligjorë. Nëse procedura e miratimit nuk ka vlerë juridike, numërimi i votave nuk ka vlerë juridike, atëherë humb sensi i rolit ligjvënës të Kuvendit dhe rolit dekretues të Presidentit.

Në rastin e ligjit për shtetësinë me të drejtë Presidenti ktheu ligjin duke konfirmuar se nuk është respektuar neni 81 i Kushtetutës, ku në votim kërkoheshin 84 vota. Pra në këtë rast Presidenti numëroi votat e deputetëve të pranishëm në tri votimet, në parim, nen për nen dhe në tërësi, kurse në rastin e ligjeve të periudhës 30 tetor – 21 dhjetor nuk u numëruan votat dhe as nuk u mor në konsideratë fakti se nuk pati dokumentim të votave dhe as mundësi për të provuar se deputetët e deklaruar kanë ushtruar të drejtën e votës.

#### 4.2. KONFLIKTUALITETI POLITIK DHE PËRGJEGJËSIA POLITIKE

Tipar dallues i sesionit parlamentar ishte gjuha e ashpër dhe denigruese në ligjërimin parlamentar, incidentet e shumta dhe fizike, si dhe shifra rekord e penalizimeve të deputetëve, 63 në dy muaj, më e larta në të gjithë historinë e parlamentit prej vitit 1924. Dhuna verbale dhe denigruese u përdor kryesisht nga politikanët kryesorë, drejtues të opozitës dhe të mazhorancës, të cilët vijuan të jenë katalizatorët kryesorë të konfliktualitetit politik. Strukturat parlamentare drejtuese dhe ato të etikës dështuan të parandalojnë situata të tilla, dhe për më tepër, nga mënyra e funksionimit dhe vendimmarrjeve u bënë gjithashtu katalizatorë për agravimin e situatës.

Riti i pjesës destruktive të opozitës, hyrja në mjediset e sallës së Kuvendit, për të zhvendosur karriget e deputetëve dhe për të dëmtuar pajisjet e punës në Kuvend, janë akte sa jo etike, por edhe vepra penale të cilat meritojnë hetim dhe vendosje përpara përgjegjësisë ligjore. Deputetët kanë një sërë mekanizmash demokratikë në dispozicion, përmes të cilave mund të shprehin kundërshtitë e tyre në rrugë politike, institucionale dhe ligjore. Nëse të gjitha dështojnë ose pamundësohen, deputetët dhe partitë e mëdha politike kanë të drejtë të organizojnë protesta dhe akte simbolike reagimi edhe brenda parlamentit, siç kanë të drejtë të aplikojnë forma më atraktive reagimi, si për shembull, bllokimi i kalendarit parlamentar përmes mijëra amendimeve

ligjore ose promovimi i debateve pa limit në foltoren e Kuvendit. Zgjedhja apriori e rrugës më të shkurtër, bllokim i sallës, dëmtim i pajisjeve, përdorim i mjeteve piroteknike dhe përplasja fizike me kolegët e tyre ose punonjësit e sigurisë, janë tregues dobësie, strategji e gabuar dhe akt që dëmton ndjeshëm si besimin publik tek parlamenti dhe vetë demokracia, ashtu edhe tek forca politike të cilës i përkasin këta deputetë.

Një nga tiparet e protestës së opozitës ishte protagonizmi i disa deputetëve në të gjitha incidentet, pra edhe treguesi se disa deputetë, në pamundësi dhe paaftësi për të prodhuar politikë, prodhojnë incidente. Deputetët zgjidhen për të bërë ligje dhe për të përfaqësuar qytetarët, alternativën pozitive dhe mundësinë e rotacionit pozitiv politik, jo për sjellje “rruge” kundër të gjitha standardeve etike parlamentare. Raste të tilla vetëm sa nxjerrin në pah defektet e sistemit përfaqësues dhe nevojën e reformimit të mënyrës dhe kriterëve të përzgjedhjeve të kandidatëve për deputetë, sidomos në kushtet e një liste proporcionale.

Dy përgjegjësitor kryesor të krizës në parlament mbeten dy liderit kryesorë politikë, kryeministri Rama dhe drejtuesi i grupit më të madh të opozitës Berisha. Secili prej tyre ka drejtuar Shqipërinë për më shumë se 10 vjet, secili prej tyre ka përvojë të pasur politike dhe secili prej tyre ka fuqinë dhe kapacitetin për të ofruar zgjidhje politike për vendin, kur vendi ndodhet në krizë, si dhe për të moderuar mbështetësit e tyre parlamentare dhe militantët në rrugë. Zoti Rama dështoi të krijojë një parlament normal dhe të ofrojë një qeverisje normale më demokratike sesa paraardhësit e tij, ndërkohë që zoti Berisha dështoi të krijojë profilin e një opozite konstruktive, duke mbajtur peng aksionin e saj politik në funksion të problemeve të tij me drejtësinë dhe ambicien e tij afatshkurtër politike.

#### **4.3. QASJA E GABUAR E OPOZITËS PARLAMENTARE**

Opozita vijoi të ishte e fragmentarizuar gjatë këtij sesioni parlamentar, shpesh edhe në konflikte të papajtueshme, të cilat u zhvendosën nga selitë politike tek vetë Kuvendi, komisionet dhe seancat. Një prej pasojave direkte të këtij konflikti të gjatë dhe të personalizuar është vonesa në funksionimin e komisionit të reformës zgjedhore. Opozita është e përbërë nga tri prurje, një grup 10–11 deputetë mbështetës të kryetarit zyrtar të PD Basha, një grup tjetër me pothuajse kaq deputetë mbështetës të ish kryeministrit Berisha, dhe pjesa tjetër, e cila statistikisht është shumicë, kundër zotit Basha dhe gjithnjë e më afër zotit Berisha. Dy grupet e fundit kanë unifikuar qëndrimet në parlament në zgjedhjen e kreut të grupit, i cili ndonëse përfaqëson shumicën absolute të deputetëve të opozitës nuk njihet i tillë nga Kuvendi.

Pas tensioneve që shkaktoi rrëzimi i nismave për komisionet hetimore dhe njohjen e legjitimitetit të shumicës që përfaqëson opozitën, aksioni parlamentar opozitar i radikalizoi qëndrimet i ndikuar sidomos nga masat ligjore të SPAK ndaj ish kryeministrit Berisha. Ndonëse shumica e deputetëve të opozitës mbështet SPAK dhe është me qëndrime të qarta pro BE dhe SHBA, mungesa e institucionalizimit të opozitës i bëri ata luajalë të krahut më radikal, i cili përmes incidenteve të shumta në parlament synoi pengimin e mbledhjeve të seancave dhe komisioneve parlamentare. Përdorimi i lëndëve piroteknike nisi një garë midis deputetëve dhe gardistëve për hyrje vs ndalime në parlament, si dhe çoi në incidente të shumta edhe fizike. Strategjia e aksionit radikal fizik rezultoi e gabuar për opozitën dhe e izoloi atë edhe më shumë nga partnerët përëndimorë. I vetmi sukses i saj ishte nxjerrja në pah e gabimeve të mazhorancës, kryesisht arrogancës së saj dhe refuzimit antikushtetues të nismave për komisione hetimore, por në tërësi strategjia ishte jo efektive dhe jo popullore në publik.

Disa deputetë me qasje konstruktive në parlament, ata që propozuan ligje ose amendime ligjore, që ankimuan akte në Gjykatën Kushtetuese ose morën pjesë në mbledhjet e strukturave parlamentare, u ndjenë të izoluar dhe nën presionin e pjesës më militante parlamentare dhe mediatike. Nga ana tjetër, grupi zyrtar i PD nuk arriti të shfaqë ndonjë strategji parlamentare dhe as të iniciojë akte që ta identifikojnë atë si alternativë dhe të aftë të përfaqësojë pritshmëritë opozitare në vend. Po ashtu, deputetët e partisë së dytë të opozitës, Partia e Lirisë, patën akses të kufizuar, u penguan dhe u ndikuan gjithashtu nga zhvillimet në lidhshimin politik të partisë, sidomos pas njoftimeve për procese hetimore nga SPAK.

#### **4.4. QASJA E GABUAR E MAZHORANCËS PARLAMENTARE**

Në mandatin e tretë politik mazhoranca kishte të gjithë mjetet në dispozicion për të siguruar stabilitet qeverisës dhe një parlament sa më funksional dhe përfaqësues. PS nuk e synoi këtë, por zgjodhi anashkalimin e parlamentit dhe suksesin e të qenit pa rivalë politikë. Kriza e opozitës ishte suksesi më i madh i saj, por vetë PS nuk pati ndikim real në krijimin e kësaj krize dhe as në jetëgjatësinë e saj. Përgjegjësia e PS ka të bëjë kryesisht me qasjen e gabuar në strategjinë parlamentare, – formalizimin e parlamentit dhe dobësimin e rolit të tij kushtetues, si dhe kontrollin absolut të agjendës parlamentare nga kabineti i kryeministrit. Mazhoranca nuk ofroi dialog parlamentar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (komisionet hetimore, reforma zgjedhore, zgjedhja e disa funksionarëve të lartë apo jetësimi i vendimeve të GJK), përkundrazi, zgjodhi konfliktualitetin, duke ashpërsuar me ligj masat kundër deputetëve të opozitës. Ndryshimet e njëanshme në Rregullore dhe aktet e njëanshme të vendimmarrjeve në parlament shënojnë një trashëgimi kritike për standardet e parlamentarizmit.

Mazhoranca gaboi edhe në administrimin e parlamentit si institucion. Deputetët e opozitës u konsideruan apriori dhe kolektivisht fajtorë kur ata u ndaluan të hyjnë në mjediset e tyre të punës (zyrat e deputetëve dhe të grupit) në kryesinë e parlamentit. Deputetëve që iniciuan ligje nga opozita iu pamundësua procedura e rregullt parlamentare dhe vota në bllok kundër çdo kërkesë të opozitës mbeti sjellje obskurantiste. Vendimmarrjet e Sekretariatit të Etikës ishin në kundërshtim me rregullat etike, dhe se gjuha parlamentare e mazhorancës ndaj opozitës ishte po ashtu arrogante dhe denigruese. PS deklaroi se nuk pranon asnjë nismë që mban firmën e ndonjë deputeti “non grata”, duke nënkuptuar shumicën e deputetëve të opozitës që janë me ose pranë S.B, por nga ana tjetër, PS kërkoi, mori dhe bashkëqeverisi me tre votat e PSD, kryetarii së cilës është më shumë se “non grata” me SHBA.



## 5. PROBLEMATIKA TË RËNDËSISHME TË AKTIVITETIT PARLAMENTAR

- I. Vendimi për kalimin e mbledhjeve të komisioneve në sistemin online, publikuar me 6 nëntor, ndërkohë që kishte hyrë në fuqi me 1 nëntor, u bë në mënyrë jo transparente dhe mbi të gjitha, i pabazuar në Rregulloren e Kuvendit (a/5 i Rregullores). Sipas Rregullores, mbledhjet online mund të zhvilloheshin vetëm në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme dhe të pandemisë, por rasti i konfliktualitetit pozitë–opozitë në parlament nuk përfshihej në Rregullore dhe as nuk kishte bazë referuese me dy situatat e mësipërme. Kuvendi dhe mazhoranca refuzuan kritikën dhe rekomandimet e ardhura nga shoqëria civile për ndërhyrje në Rregullore dhe kthimin e aktivitetit parlamentar në shtratin kushtetues dhe ligjor. Vetëm në dhjetor, kur parlamenti ishte më shumë se një muaj në gjendje joligjore, mazhoranca inicioi ndryshime në Rregulloren e Kuvendit, duke përfshirë tek rastet e mbledhjeve online edhe rastin e krijuar aktualisht në parlament, pamundësinë e zhvillimit të mbledhjeve për shkak të incidenteve.
- II. Drejtuesi i Kuvendit dhe mazhoranca përdorën në së paku tre raste ndryshimin e minutës së fundit të rendit të punës së Kuvendit, duke përfshirë në kalendar akte të politikës së ditës, pa respektuar praktikën e mira të diskutimit dhe vendimmarrjes konsensuale në konferencën e Kryetarëve. Përfshirja e akteve të tilla p.sh., në një seancë ku ishte paraparë diskutimi për rezolutën për situatën në Kosovë, solli përplasje midis palëve dhela në hije thelbin e diskutimit, situatën në Kosovë, duke marrë vëmendje vendimi i mazhorancës për refuzimin e nismave hetimore të opozitës. Më 9 nëntor mazhoranca përdori të njëjtin truk, duke përfshirë në procedurë të minutës së fundit disa nisma të vjetra ligjore të deputetëve të opozitës, me qëllim rrëzimin e tyre pa debat, siç edhe ndodhi. Po ashtu, e njëjta situatë u përsërit në dhjetor me ndryshimet e njëanshme në ligjin mbi komisionet hetimore, për Rregulloren e Kuvendit dhe për marrëveshjen midis Shqipërisë dhe Italisë.
- III. Në rastin e ligjit për shtetësinë, ndonëse Kushtetuta parashikon 84 vota (neni 81 i Kushtetutës) rezultoi se gjatë votimit të neneve numri i deputetëve mbështetës ishte shumë më i vogël, duke e vendosur ligjin në kundërshtim me Kushtetutën. Presidenti e riktheu ligjin për diskutim, mazhoranca e pranoi gabimin gjatë diskutimit në Komision, por pyetja është, – si është e mundur që Kuvendi, me 140 deputetë dhe me staf mbështetës, nuk e parandaloi konfliktin kushtetues që në momentet e diskutimit dhe miratimit të ligjit? Gjatë debatit në seancë deputeti Oerd Bylykbashi (PD) e paralajmëroi se kemi të bëjmë me shkelje kushtetuese, por drejtuesit e seancës nuk e morën në konsideratë kritikën, si pothuajse të gjitha kritikën që vijuan nga deputetë të opozitës. Kjo

qasje e gabuar meriton vëmendje dhe korrektim nga Kryetari i Kuvendit, Konferenca e Kryetarëve dhe kryetarët e grupeve parlamentare, sidomos kur bëhet fjalë për çështje kushtetuese, respektim ligji dhe diskutim të iniciuar nga deputetët juristë.

- IV. Kuvendi në seancën plenare të datës 09.11.2023 ka shqyrtuar 3 nismat ligjvënëse të deputetëve opozitarë, konkretisht ndryshime në Kodin Penal. Nga të dhënat monitoruese rezulton se deputetët e opozitës nuk kanë marrë pjesë në votim dhe të tri nismat janë rrëzuar me arsyetimin se nuk kanë arritur shumicën e nevojshme të votave për miratim (në këtë rast është jo më pak se 84 vota pro). Rezultati i votimit për të tri nismat ka qenë 75 vota kundër, asnjë pro, asnjë abstenim<sup>2</sup> që do të thotë se në proces votimi kanë marrë pjesë gjithsej 75 deputetë. Referuar jurisprudencës kushtetuese dhe Rregullores së Kuvendit "Për përcaktimin e kuorumit dhe të shumicës së deputetëve, Kryetari i Kuvendit i referohet vetëm numrit të deputetëve që kanë votuar". Ligjet që kërkojnë një shumicë të cilësuar për miratim, konkretisht 3/5 dhe 2/3 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, kërkojnë domosdoshmërisht kuorumin prej 3/5 dhe 2/3 të të gjithë anëtarëve<sup>3</sup>. Mungesa e numrit të duhur ligjor përbën shkak për pavlefshmëri votimi.
- V. Kuvendi, gjatë procedurave vendimmarrëse, përveç votimit elektronik, aplikoi edhe votimin me kartona kryesisht gjatë votimit nen për nen të projektligjeve apo kërkesave të ndryshme procedurale të paraqitura. Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën si organi përgjegjës i Kuvendit, që ndjek dhe mbikëqyr veprimtarinë procedurale të Kuvendit në seancë plenare nuk dokumenton procesin vendimmarrës. Votimi me kartona vë në pikëpyetje legjitimitetin e vendimmarrjes për sa kohë që nuk verifikohet kuorumi dhe shumica e kërkuar për miratim. Rezulton se në shumë raste Kuvendi ka marrë vendime pa kuorumin e kërkuar nga Kushtetuta.
- VI. Shkelje procedurale në shqyrtimin e disa projektligjeve janë konstatuar edhe gjatë shqyrtimit në komisionet parlamentare si p.sh. për Sigurinë Kombëtare, për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, për Ekonominë dhe Financat. Nga të dhënat monitoruese rezulton se votimi në komision është kryer në kundërshtim me rregullat e procedurës. Në procesin e votimit nuk ka marrë pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit në mënyrë që të legjitimohet vendimmarrja. Vendimmarrje pa kuorumin e duhur rezulton të ketë ndodhur në KSK në votimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 113/2020, "Për shtetësinë"" ku në procesin e votimit

<sup>2</sup> Shih procesverbalin e seancës plenare të datës 09.11.2023 në linkun <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202312051304443367Procesverbal,%20dat%C3%AB%209.11.2023.pdf> fq. 6 (Aksesuar për herë të fundit më 15.01.2024)

<sup>3</sup> Shih vendimet nr. 29/2009 dhe 44/2011 të Gjykatës Kushtetuese

kanë marrë pjesë vetëm 10 deputetë të cilët nuk përbëjnë shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për të legjitimuar vendimmarrjen<sup>4</sup>, përsëri në KSK në votimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar” ku në procesin e votimit kanë marrë pjesë vetëm 11 deputetë<sup>5</sup> si dhe në votimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” nismë deputeti ku në procesin e votimit kanë marrë pjesë vetëm 12 deputetë<sup>6</sup>.

Pavlefshmëri votimi është konstatuar gjithashtu edhe gjatë votimit të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi) dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim (huadhënësi), për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri – Faza II”” shqyrtuar në KÇLAPDNJ ku në procesin e votimit kanë marrë pjesë 11 deputetë<sup>7</sup> si dhe në votimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër – hua për politikën e zhvillimit” shqyrtuar në KEF ku në procesin e votimit kanë marrë pjesë vetëm 11 deputetë<sup>8</sup>.

- VII. Procesi vendimmarrës në Kuvend realizohet nëpërmjet sistemit elektronik të votimit, organizimi dhe funksionimi i të cilit është disiplinuar me vendimin nr. 69, datë 25.2.2021 të Byrosë së Kuvendit. Referuar këtyre rregullave “*drejtuesi i seancës plenare, përpara verifikimit të kuorumit, urdhëron kontrollin e kartave dhe ç’aktivizimin e tyre nga sistemi në rastet kur deputeti nuk është i pranishëm*”. Mosrespektimi i këtyre rregullave

<sup>4</sup> Shih raportin e komisionit për Sigurinë Kombëtare për këtë projektligj në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202307191502357696Raport%20Komision%20Peraqjeges,%20Komisioni%20per%20Sigurine%20Kombetare.pdf>

(Aksesuar për herë të fundit më 15.01.2024)

<sup>5</sup> Shih raportin e komisionit për Sigurinë Kombëtare për këtë projektligj në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202309140828496852Raporti%20final%20Komisioni%20i%20Sigurise.pdf>

(Aksesuar për herë të fundit më 15.01.2024)

<sup>6</sup> Shih raportin e komisionit për Sigurinë Kombëtare për këtë projektligj në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202310251042162023RAPORT%20I%20KOMISIONIT%20PER%20SIGURINE%20KOMBETARE.pdf>

(Aksesuar për herë të fundit më 15.01.2024) dhe procesverbalin e komisionit datë 18.10.2023 në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202311071431009269Komisioni%20i%20%20Sigurise%2018.10.2023.pdf>

(Aksesuar për herë të fundit më 15.01.2024)

<sup>7</sup> Shih raportin e komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për këtë projektligj në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20231025122332395Raport%20Komisioni%20per%20%20C3%87%20C3%ABshtjet%20Ligjore,%20Administrat%C3%ABn%20Publike%20dhe%20t%C3%AB%20Drejtat%20e%20Njeriut.pdf>

(Aksesuar për herë të fundit më 15.01.2024)

<sup>8</sup> Shih raportin e komisionit për Ekonominë dhe Financat për këtë projektligj në linkun

[https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202311071716142341Raport%20KEF\\_PRGJ-Ratifikim%20zhvillimi%20i%20Gjelber.pdf](https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202311071716142341Raport%20KEF_PRGJ-Ratifikim%20zhvillimi%20i%20Gjelber.pdf)

(Aksesuar për herë të fundit më 15.01.2024)

pamundëson paraqitjen e një pasqyre të plotë dhe reale të procesit vendimmarrës në fletët e votimit. Deputetët që mungojnë në seancë plenare gjatë procesit vendimmarrës figurojnë si të pranishëm, por që nuk dëshirojnë të marrin pjesë në votim, dy koncepte këto krejtësisht të ndryshme<sup>9</sup>.

- VIII. Komisionet e përhershme i shqyrtojnë projektligjet përgjithësisht dy ditë (në disa raste edhe një ditë) përpara shqyrtimit në seancë plenare, praktikë e dëmshme për cilësinë e legjislacionit<sup>10</sup>. Kjo i privon deputetët në seancë plenare nga një diskutim cilësor dhe i argumentuar si dhe nga vendimmarrja. Përgjithësisht, raportet e komisioneve nuk reflektojnë rezultatin e votimit ndërsa, për sa i përket deputetëve se si kanë votuar në komision, këta të fundit nuk identifikohen në asnjë rast.
- IX. Kuadri normativ për etikën parashikon gjithashtu, edhe ngritjen dhe plotësimin e Regjistrimit të Masave Disiplinore me të dhënat për masat disiplinore të marra<sup>11</sup>. Nga të dhënat monitoruese rezulton se asnjë regjistër i tillë nuk është mbajtur dhe publikuar në faqen e Kuvendit në internet. Kuvendi nuk e ka përmbushur këtë detyrim ligjor.
- X. Kuvendi nuk ka krijuar ende një sistem të plotë dhe efikas transparence. Faqja paraqet vështirësi në gjetjen e materialeve. Përdorimi i mekanizmave të kërkimit duhet të jenë sa më të lehta për qytetarët me qëllim gjetjen e informacionit në një kohë të shkurtër dhe të shpejtë duke krijuar baza të të dhënave dhe duke mundësuar kërkime të thjeshta dhe komplekse përmes përdorimit të metadatave të duhura.
- XI. Dokumente dhe të dhëna me rëndësi publike sikurse procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve, kontaktet e deputetëve me lobistët, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit (përfshirë kontaktet jashtë mbledhjeve të Kuvendit dhe komisioneve të tij) si dhe elementë të tjerë të Kodit të Sjelljes, CV e kandidaturave – pjesë e detyrimit për publikim, – ndryshe sa detyron Rregullorja e Kuvendit, Kodi i Sjelljes dhe aktet e brendshme, nuk janë ende online në dispozicion të publikut. Zbatimi i suksesshëm i legjislacionit për akses në dokumente publike është parakusht i domosdoshëm për një Kuvend transparent dhe bashkëpunues. Transparenca është parimi themelor mbi të cilin zhvillojnë veprimtarinë institucionet publike dhe faktor në përmirësimin e cilësisë së

<sup>9</sup> Një rast është ai i Kryeministrit E. Rama në votimin e rezolutës për Kosovën. Referuar tabulateve të fletëve të votimit, të publikuara në faqen e Kuvendit, Kryeministri figuron të ketë qenë i pranishëm por që nuk e ka votuar rezolutën (ndërkohë që ka munguar). Shih link

[https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202310131142492040Flet%C3%AB%20votimi,%20dat%C3%AB%2012%20tetor%202023%20\(Rezoluta%20p%C3%ABr%20Kosov%C3%ABn\).pdf](https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202310131142492040Flet%C3%AB%20votimi,%20dat%C3%AB%2012%20tetor%202023%20(Rezoluta%20p%C3%ABr%20Kosov%C3%ABn).pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 15.01.2024)

<sup>10</sup> Shih tabelën bashkëngjitur raportit

<sup>11</sup> Udhëzuesi i Detajuar për Sjelljen në Kuvend, pika 31

qeverisjes, forcimin e demokracisë dhe respektimin më të mirë të të drejtave të njeriut prandaj një parlament duhet të jetë i hapur dhe bashkëpunues.

- XII. Kuvendi ka shënuar regres në drejtim të disa elementëve të transparencës, sidomos në aspektin statistikor. “Buletini statistikor 2021–2025” ofruar online nga Kuvendi me bilancin e akteve, votimeve, kohës së debatit, angazhimeve gjinore dhe politike, mbi natyrën e akteve dhe vendimmarrjet, broshura “Shpërndarja e deputetëve në organet e Kuvendit” apo Manuali “Mandatet Parlamentare 2021–2025”, ndonëse në fillim të legjislaturës përbënë një zhvillim pozitiv dhe plotësuan një prej mangësive të legjislaturave të kaluara kanë mbetur të papërditësuara prej shumë kohësh. Gjithashtu Buletini Informativ, periodik dy–muor me aktivitetin e seancës plenare apo Newsletter me aktivitetin e seancës plenare, të cilat përbënin gjithashtu risi dhe kontribut pozitiv në drejtim të konceptit “parlament i hapur”, nuk janë më në dispozicion të publikut.
- XIII. Kuvendi ka shfaqur në mënyrë të vazhdueshme probleme në respektimin e afateve dhe standardeve të parashikuara nga Rregullorja e Kuvendit dhe aktet e brendshme, lidhur me publikimin e rendit të ditës për seancën plenare. Ky i fundit publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit me vonesë duke shkelur edhe minimumin e afatit prej jo më vonë se 48 orë përpara seancës plenare<sup>12</sup> dhe me mungesë të raporteve të komisioneve parlamentare. Në shumë raste raportet janë publikuar vetëm pak orë përpara kalimit të projekt–aktit për shqyrtim në seancë plenare duke kufizuar ndjeshëm mundësinë e reagimit të ekspertëve dhe zërave të grupeve të interesit ndërkohë që rregullat e procedurës (neni 70/4) parashikojnë shpërndarjen e tyre të paktën 1 javë përpara datës së shqyrtimit të projektligjit në seancë.
- XIV. Kuvendi në seancën plenare të datës 12.10.2023 ka votuar projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”. Nga të dhënat monitoruese rezulton se votimi në parim është kryer në kundërshtim të plotë me Kushtetutën për shkak të mungesës së numrit të duhur ligjor e cila përbën shkak për pavlefshmëri votimi. Referuar fletës së votimit të publikuar në faqen e Kuvendit në internet rezultojnë se në votim kanë marrë pjesë 64 deputetë<sup>13</sup> ndërsa referuar jurisprudencës kushtetuese (vendimi nr. 44/2011) por edhe Rregullores së Kuvendit (neni 55, pika 4) për përcaktimin e kuorumit dhe të shumicës së deputetëve, Kryetari i Kuvendit i referohet vetëm numrit të deputetëve që kanë votuar. Ligji në fjalë është konsideruar i

<sup>12</sup> Referuar rregullave të procedurës (neni 27/1, pika 3) rendi i ditës i seancës plenare bëhet publik si rregull 7 ditë përpara, por jo më vonë se 2 ditë përpara datës së caktuar për seancën plenare. Referuar afatit 48 orësh rendi i ditës duhet të publikohet jo më vonë se ora 10.00 e ditës së martë në rast mbledhjeje të Kuvendit në seancë plenare ditën e enjte ora 10.00.

<sup>13</sup> Shih: <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202310131130326765Flet%C3%AB%20votimi.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 15.01.2024)

miratuar dhe i është kaluar Presidentit të Republikës për shpallje si dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare për publikim.

- XV. Debati në seancë plenare nuk respekton rregullat e procedurës dhe që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e fjalimit parlamentar, respektimin e radhës së folësve dhe në veçanti, diskutimin brenda thelbit të çështjes. Seanca ndodhet shpesh para situatave të mungesës së dialogut midis forcave politike dhe për pasojë, të mosgjetjes së zgjidhjeve konsensuale. Seancat plenare janë aspekti më i rëndësishëm i jetës parlamentare prandaj deputetët duhet ta përdorin atë për të dëshmuar aftësitë, angazhimin, bindjen politike, parimet që mbrojnë dhe për të respektuar kontratën me zgjedhësit.
- XVI. Kuvendi në seancën plenare të datës 21.09.2023 ka votuar projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 113/2020, "Për shtetësinë"<sup>14</sup>. Nga të dhënat monitoruese rezulton se amendamentet e paraqitura nga deputetët e grupit parlamentar të Partisë Socialiste për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 113/2020, "Për shtetësinë"<sup>14</sup> nuk kanë arritur shumicën e cilësuar prej 3/5 të të gjithë anëtarëve të Kuvendit sikurse e kërkon Kushtetuta<sup>15</sup>. Pavarësisht kësaj, amendamentet janë konsideruar të miratuara dhe ligji i është kaluar Presidentit të Republikës për shpallje, i cili po për këtë arsye, ktheu për rishqyrtim ligjin në Kuvend.
- XVII. Kuvendi në seancat plenare të datës 11 dhe 14 shtator 2023 ka shqyrtuar një sërë dekretesh të Presidentit të Republikës për shkarkim dhe emërim ministri. Rezulton se dekretet në fjalë, me gjithë përpjekjet e deputetëve opozitarë për të kërkuar debat, nuk janë bërë objekt diskutimi në seancë plenare me arsyetimin se "Referuar praktikës parlamentare disavjeçare, seancat plenare për shkarkim dhe emërim ministrash janë zhvilluar dhe zhvillohen pa debat"<sup>16</sup>. Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 6, datë 18.1.2002 ka bërë interpretimin përfundimtar të nenit 98 të Kushtetutës duke nënvizuar se me fjalën "shqyrtim", sipas nenit 98 të Kushtetutës, kuptohet e drejta dhe detyrimi i Kuvendit për të bërë objekt diskutimi e debati dekretin e Presidentit të Republikës për emërim dhe shkarkim ministri dhe për të marrë një vendim të caktuar për miratimin ose mosmiratimin e tij. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme

<sup>14</sup> Shih procesverbalin e seancës plenare 21.09.2023 në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202310031013223032Procesverbal,%20dat%C3%AB%2021.9.2023.pdf>  
fq. 97–98 (Aksesuar për herë të fundit më 15.01.2024)

<sup>15</sup> Shih fletët e votimit në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202309221125560373Flet%C3%AB%20votimi.pdf>  
(Aksesuar për herë të fundit më 15.01.2024)

<sup>16</sup> Shih procesverbalin e seancës plenare të datës 11.09.2023 në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202310031138431655Procesverbal,%20dat%C3%AB%2011.9.2023.pdf>  
fq. 2 (Aksesuar për herë të fundit më 15.01.2024)

dhe janë përfundimtare. Për pasojë, Kuvendi nuk ka të drejtë të zhvlerësojë vendimmarrjen kushtetuese por vetëm ta zbatojë atë.

- XVIII. Më 11 shtator Kuvendi u ndodh në një situatë atipike, kur ministri i ri i financave ishte njëherësh edhe drejtor i AMF-së, papajtueshmëri e përcaktuar nga Kushtetuta si kriter për dekretim si ministër. Përmes një procedure të negociuar palët (Presidenti, Kryeministri dhe Kuvendi) e gjetën zgjidhjen duke bërë dy votime, fillimisht shkarkimin nga funksioni në AMF dhe më pas dekretimin si ministër. Shkarkimi u bë nga dy pozicione, si Kryetar i Bordit të Autoritetit për Mbikëqyrjen Financiare si dhe nga funksioni i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, por si i tillë mbetet një vendim tërësisht i paqartë (botuar edhe në Fletoren Zyrtare nr. 133/2023) për sa kohë që personi në fjalë nuk ka mbajtur funksionin e Kryetarit të Bordit, por atë të anëtarit të Bordit që mbante funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.
- XIX. Më 2 tetor kishin dhënë emrat për diskutim për zonat e tyre elektorale dhe problematikat me zgjedhësit rreth 36 deputetë. Disa prej tyre u ankuan për kohën e shkurtër në dispozicion. Bazuar në qëllimin e javës së gjelbër, ekspertët e ISP-në mendojnë se pretendimet e deputetëve janë të sakta dhe duhet të merren në konsideratë. Çfarë e pengon parlamentin të zgjasë debatin, në të cilin deputetët në tërësi diskutojnë për zonat e tyre dhe nuk ka konfliktualitet politik? Kuvendi nuk ka një agjendë të ngjeshur dhe deputetët nuk janë aq shumë të ngarkuar me punë sa të mos kenë kohë për të dëgjuar njëri tjetrin në diskutimet për problematikat lokale dhe për më tepër, është rasti i vetëm kur një pjesë e deputetëve e kanë këtë mundësi diskutimi.
- XX. Nga ana tjetër, thelbi i javës së gjelbër nuk është vetëm debati politik, por edhe qasje reflektive, reagimi ndaj problematikave që citohen nga deputetët. Kuvendi duhet të ketë një grup pune që mban shënim dhe ndjek jetësimin dhe zgjidhjen e çështjeve lokale që ngrenë deputetët, si dhe duhet të mbështesë praktikën që ministri i shtetit ose zv/kryeministri të raportojnë periodikisht në Kuvend për të gjitha problematikat e ngritura nga deputetët. Kjo do ta bënte parlamentin më funksional, debatin më me produktivitet dhe pozitën e deputetit më afër qytetarëve të zonës që përfaqëson.
- XXI. Nga të dhënat monitoruese rezulton se Kryetarja e Kuvendit, në respektim të nenit 65 të Rregullores, ka marrë masën disiplinore “Përjashtim nga seanca plenare” ndaj disa deputetëve por në asnjë rast masa e marrë nuk është formalizuar me aktin juridik konkret të përcaktuar me Rregullore Kuvendi. Neni 7 pika 6 e Rregullores parashikon shprehimisht se *“Në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave të tij, Kryetari i Kuvendit nxjerr urdhra dhe udhëzime”*.

- XXII. Referuar Rregullores së Kuvendit (neni 65/1) masa disiplinore më e rëndë (përpara ndryshimeve të Rregullores) ishte ajo e përjashtimit nga seancat plenare dhe komisionet, apo e ndalimit të pjesëmarrjes në to, për një afat deri në 10 ditë, shqyrtimi dhe dhënia e së cilës është në kompetencën e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën. Sekretariati e ka aplikuar disa herë këtë masë por të dhënat monitoruese tregojnë se Kuvendi në aplikimin e kësaj mase disiplinore i është referuar llogaritjes së afatit me ditë kalendarike ndërkohë që dispozitat e Rregullores, konkretisht neni 65/2, pika 4 përcaktojnë llogaritjen me ditë pune. Mosllogaritja sipas rregullave të parashikuara me Rregullore shkaktoi përplasje midis mazhorancës dhe opozitës në lidhje me mbarimin e afatit 10–ditor. Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën duhet të kishte saktësuar në dispozitivin e vendimeve *për dhënie mase disiplinore*, llogaritjen e masës me ditë pune sikurse parashikon neni 65/2 pika 4 e Rregullores së Kuvendit.
- XXIII. Referuar kuadrit normativ Byroja e Kuvendit ka detyrimin e hartimit të raportit vjetor lidhur me rastet e shkeljes së Kodit të Sjelljes si dhe masat disiplinore të marra ndaj deputetëve për këto shkelje<sup>17</sup>. Ky parashikim është në kuadër të rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë të cilat u rekomandojnë parlamenteve publikimin e një raporti që përfshin të gjitha ankesat dhe raportimet për shkeljen e rregullave të Kodit duke vënë në dukje gjithashtu trajtimin e tyre<sup>18</sup>. Pavarësisht kësaj, ky parashikim ligjor nuk ka gjetur zbatim.

---

<sup>17</sup> Udhëzuesi i Detajuar për Sjelljen në Kuvend, pika 27

<sup>18</sup> Shih: *Commonwealth AntiCorruption Benchmarks*, (Commonwealth Secretariat) 2021 fq. 46–48 cit. në linkun [https://production-new-commonwealth-files.s3.eu-west-2.amazonaws.com/s3fs-public/2022-04/Anti-Corruption%20Benchmarks\\_UPDF.pdf?VersionId=mDx64yykQWIJ\\_T.XhdkOnEtyf\\_NH\\_n4b](https://production-new-commonwealth-files.s3.eu-west-2.amazonaws.com/s3fs-public/2022-04/Anti-Corruption%20Benchmarks_UPDF.pdf?VersionId=mDx64yykQWIJ_T.XhdkOnEtyf_NH_n4b) (Aksesuar për herë të fundit më 23.12.2023)




## 6. VLERËSIMI I PËRFORMANCËS SË DEPUTETËVE DHE GRUPEVE

Bazuar në ndryshimet metodologjike të cituara në fillim të raportit dhe në praktikën e deritanishme monitoruese, stafi i ISP-së mbledhi të dhëna për të gjithë deputetët dhe kalkuloi treguesit e performancës së tyre. Në dallim nga raportet e mëparshme nuk do të paraqesim të dhëna të detajuara për secilin deputet, por të dhënat që kanë rëndësi publike.

### 6.1. DEPUTETËT MË EFEKTIVË NË PARLAMENT

Nga të dhënat krahasuese rezulton se deputetët e PL (ish LSI) kanë nivelin më të lartë të angazhimit në aktivitetin parlamentar me mesatarisht 14 pikë, ndjekur nga deputetët e PD me nga 11 pikë dhe ata të PS me 10 pikë. Deputetët e PDIU kanë vetëm 5 pikë angazhim në mesatare të përbashkët, kurse ata të PSD në kufijtë e 1 pike, minimumi i mundshëm i vlerësimit të deputetëve..



Kur PD kalkulohet në tri grupimet, rezulton se grupi i Bashës është më aktiv (14 pikë mesatare), ata pa grup me 13 pikë mesatare dhe ata pro Berishës me 11 pikë mesatare. Ky vlerësim vlen edhe nga fakti se disa deputetë të dy grupeve të mëdha (pa grup dhe ata pro Berishës) nuk janë aktiv duke bërë kontrast me një pjesë shumë aktive, por që në mesataren e përbashkët kuota e angazhimit bie. Tek rasti i grupit Basha përqindja e lartë e angazhimit lidhet edhe me faktin se

janë më pak deputetë dhe shumica janë aktiv, pra edhe në kalkulimin e mesatares, përqindja rezulton më e lartë.

Edhe në kalkulimin e nivelit të efikasitetit të deputetëve mbi bazë gjinore, nuk ka surpriza, – prej vitesh deputetet janë shumë me aktivë sesa grupi (M). Në rastin aktual gratë deputete kanë nivel mesatar efikasiteti 11 pikë, ndaj 9 pikëve mesatare për deputetët e gjinisë tjetër.

Tabela paraqet deputetët më efektivë në grupet kryesore politike, PS dhe PD. Nga të dhënat krahasuese me sesionet e mëparshme parlamentare nuk ka surpriza të mëdha, pothuajse të njëjtit deputetë (Tabaku, Braçe, Zhupa, Bushka, Çupi, Shalsi, etj) janë deputetët me nivelin më të lartë të angazhimit në diskutimet dhe në ushtrimin e përgjegjësive parlamentare.

DEPUTETËT MË EFEKTIVË NGA PD		DEPUTETËT MË EFEKTIVË NGA PS	
<i>Emri i deputetit</i>	<i>Partia</i>	<i>Emri i deputetit</i>	<i>Partia</i>
<b>Jorida Tabaku</b>	<b>PD</b>	<b>Erion Braçe</b>	<b>PS</b>
<b>Ina Zhupa</b>	<b>PD2</b>	<b>Klotilda Bushka</b>	<b>PS</b>
<b>Dhurata Çupi</b>	<b>PD2</b>	<b>Nasip Naço</b>	<b>PS</b>
<b>Oerd Bylykbashi</b>	<b>PD2</b>	<b>Eduard Shalsi</b>	<b>PS</b>
<b>Emilja Koliqi</b>	<b>PD</b>	<b>Lavdrim Krashi</b>	<b>PS</b>
Arbi Agalliu	PD1	Antoneta Dhima	PS
Asllan Dogjani	PD2	Arben Pëllumbi	PS
Bujar Leskaj	PD2	Petro Koçi	PS
Saimir Korreshi	PD2	Klevis Xhoxhi	PS
Kreshnik Çollaku	PD1	Ermonela Felaj	PS
Luan Baçi	PD2	Denis Deliu	PS
Zheni Gjergji	PD1	Evis Kushi	PS
Dashnor Sula	PD2	Klodiana Spahiu	PS
Eralda Bano	PD1	Milva Ekonomi	PS
Greta Bardeli	PD2	Alban Xhelili	PS
Xhelal Mziu	PD2	Etilda Gjonaj	PS

## 6.2. DEPUTETËT ME 0 DISKUTIME GJATË SESIONIT PARLAMENTAR

Në total 41 deputetë ose 30% e totalit të deputetëve nuk lanë gjurmë në memorien parlamentare, duke mos pasur asnjë fjalim as në seancat e rregullta shtator–tetor. Lista e deputetëve “pa zë” në këtë sesion parlamentar përbëhet nga deputetë të njohur por edhe nga prurjet anonime të zgjedhjeve 2021. Konkretisht, në listë të deputetëve me 0 diskutime në sesionin shtator–dhjetor 2023 bëjnë pjesë: Agron Çela, Anduel Tahiraj, Anila Denaj, Arben Pëllumbi, Arben Ahmetaj, Arkend Balla, Baftjar Zeqaj, Edi Paloka, Enkelejd Alibeaj, Enslemvera Zake, Ervin Salianji, Evis Kushi, Flamur Hoxha, Frrok Gjini, Gertjan Deda, Gledis Çeliku, Helidon Bushati, Ilda Dhori, Ilir Ndraxhi, Ilir Topi, Jurgis Çyrbja, Kasem Mahmutaj, Kastriot Piroli, Klevis Xhoxhi, Laert Duraj, Luan Duzha, Luljeta Bozo, Lulzim Basha, Meri Markiçi, Merita Baku, Mesila Doda, Niko Kuri, Nusret Avdulla, Oriela Nebiaj, Orjola Pampuri, Ornaldo Rakipi, Paulin Sterkaj, Petrit Doda, Seladin Jakupllari, Shkëlqim Bullari dhe Shpëtim Idrizi.

Ndërkohë deputetët më me shumë fjalime gjatë sesionit janë Tabaku, Zhupa, Bylykbashi, Berisha dhe Shehu (PD), Dhima dhe Resulaj (PS), të gjithë me nga 5 diskutime parlamentare, kryesisht në seancat e rregullta të periudhës shtator–tetor 2023. Më tej me nga 4 kontribute në diskutimet parlamentare renditen Agalliu, Dogjani, Leskaj, Bardeli, Korreshi, Gështenja (PD), Vasili (PL) si dhe Balla e Koçi (PS). Siç shihet, deputetët e PS–së kanë qenë shumë më pak aktivë sesa ata të opozitës, ndonëse këta të fundit janë të ndarë në minimumi dy fraksione politike.

## 6.3. KOMISIONET HETIMORE, PIKËNISJA E KONFLIKTIT POLITIK NË PARLAMENT

Në prag të sesionit parlamentar të vjeshtës opozita shpalli synimin e saj për të përdorur mekanizmin kushtetues të komisioneve hetimore si prioritar në aksionin politik në parlament. Sipas Kushtetutës, neni 77, *“Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një së katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë”*. Parimi kushtetues është i qartë dhe favorizon mundësinë e opozitave politike për të ushtruar kontroll parlamentar përmes këtij mekaniizmi.

Në kontrast me parimin mazhoranca përdori pretendime proceduriale për të refuzuar në bllok të gjitha nismat e opozitës për komisione hetimore. Sipas PS–së, parimi kushtetues i të drejtës së pakufizuar të një të katërtës së deputetëve është ndryshuar nga një prej interpretimeve të Gjykatës Kushtetuese (2022), sipas të cilit, kjo e drejtë nuk mund të konsiderohet absolutisht e pakufizuar dhe ky kufizim është i lidhur me detyrimin që objekti i hetimit të respektojë parimet dhe standardet kushtetuese, ndër të tjera, veçanërisht ato që lidhen me parimin e ndarjes e

balancimit ndërmjet pushteteve, të drejtën për një proces të rregullt ligjor, prezumimin e pafajësisë, paanshmërinë dhe respektimin e jetës private të individit". De facto rrëzimi në bllok i nismave për komisione hetimore nuk lidhej me debatet rreth klauzolave ligjore por nga synimi i mazhorancës për të frenuar aksionin prioritar politik të opozitës dhe hetimet ndaj saj. Mazhoranca e keqpërdori parlamentin në funksion të këtij qëllimi. Nga ana tjetër, edhe opozita e keqpërdori të drejtën kushtetuese duke iniciuar komisione të shumta, disa prej të cilave mund të ishin evituar, për shkak të subjektivitetit politik që në objekt.

Në shtator opozita kërkoi ngritjen e një komisioni hetimor për rrjedhjen e të dhënave personale dhe një tjetër komision për hetimin e katër kontratave koncensionare në shëndetësi. Në tetor opozita inicioi edhe një komision hetimor për parandalimin e konfliktit të interesit në funksione publike. Të tri nismat e opozitës u refuzuan nga mazhoranca dhe drejtuesi i parlamentit, bazuar në interpretime politike.

Ndërkohë, të njëjtin vendim mazhoranca pati marrë edhe ndaj nismave të tjera të opozitës për ngritje të komisioneve hetimore, si komisioni për rastin "Becheti", për komisionin për hetimin e investimeve strategjike dhe rolin e ministres së jashtme në këtë proces, për komisionin hetimor lidhur me skandalin McGonigal, për komisionin hetimor për Portin e Durrësit, si dhe për komisionin hetimor për shpenzimet e udhëtimeve me avion të kryeministrit Rama. I vetmi komision i pranuar nga mazhoranca ishte ai për inceneratorët, i cili ndonëse me votat e shumicës nuk pati vendimmarrje efektive, mendimi i pakicës u konfirmua nga hetimet e SPAK dhe rezultoi të ishte një histori suksesi në jetën parlamentare.

Dy nisma të opozitës për ndërhyrje përmirësuese në ligjin mbi komisionet hetimore nuk u përfshinë në kalendarin parlamentar për më shumë se një vit, ndërkohë që gjatë vjeshtës, pa praninë e opozitës dhe në kulmin e krizës politike, mazhoranca inicioi ndryshime të njëanshme në ligj, duke përfshirë klauzola që mund të kthehen në pengesë në jetësimin e konceptit kushtetues të kontrollit parlamentar. Nisma u iniciua formalisht nga zv/kryetarja e Kuvendit Felaj, një prej deputeteve më aktive në rrëzimin e nismave të opozitës dhe kundër vendimmarrjes antikorrupsion në komisionin për inceneratorët.


Në përfundim, gjetjet e ISP konfirmojnë kritikën e adresuar edhe në raportin e BE për Shqipërinë 2023 për kufizimin e ndjeshëm të aksesit për komisione hetimore, por edhe e shohin problematikën si akt më shumë politik, sesa juridik. Mazhoranca mund të miratonte parimisht komisionet, për të negociuar më pas objektin teknik dhe kalendarin e punës; e kundërta, refuzimi apriori përbën një praktikë negative dhe një zhvillim pas në standardet e parlamentarizmit në Shqipëri.

#### 6.4. PËRJASHTIMET E DEPUTETËVE NË REKORDE HISTORIKE

Kuvendi miratoi ndryshime në aktin bazë të organizimit dhe funksionimit të tij duke ashpërsuar masat disiplinore si kundërpërgjigje ndaj veprimeve të opozitës në sallën e seancave plenare. Ndryshimet erdhën pa një analizë paraprake të Rregullores, pa proces konsultimi dhe pa bashkëpunimin e të gjitha forcave politike në Kuvend, elementë këto të domosdoshëm dhe të nevojshëm në drejtim të emancipimit të mëtejshëm të procedurës që zhvillohet në parlament për ndryshime në Rregullore.


Janë përjashtuar me masa disiplinore gjatë periudhës tetor–dhjetor 2023:

- 🇲🇰 5 (pesë) herë deputetët: Gazmend Bardhi, Flamur Noka dhe Bledion Nallbati.
- 🇲🇰 4 (katër) herë deputetët: Albana Vokshi.
- 🇲🇰 3 (tre) herë deputetët: Asllan Dogjani, Edmond Spaho, Elda Hoti, Lefter Gështenja, Luan Baçi, Saimir Korreshi.
- 🇲🇰 2 (dy) herë deputetët: Edi Paloka, Ervin Salianji, Isuf Çela, Kastriot Piroli, Lindita Metaliaj, Sali Berisha, Xhelal Mziu.
- 🇲🇰 1 (një) herë deputetët: Bujar Leskaj, Flamur Hoxha, Greta Bardeli, Helidon Bushati, Ina Zhupa, Kasëm Mahmutaj, Lodovik Hasani, Petrit Doda, Ramadan Likaj, Sorina Koti, Tritan Shehu, Zheni Gjergji.



Nga të dhënat e ofruara në tabelë, vetëm në një rast pati 23 penalizime të deputetëve, numri më i madh i deputetëve të penalizuar në një seancë plenare gjatë gjithë historisë së parlamentit në Shqipëri. Siç tregon edhe tabela historike, në parlament ka pasur ngjarje shumë më të dhunshme dhe më me pasoja sesa bllokimi i podiumit më 19 tetor 2023, megjithatë mazhoranca zgjodhi të dëshmojë forcën, duke marrë masa në bllok për rreth 45% të deputetëve të opozitës parlamentare. Sipas Rregullores do të duhej që penalizimi të bazohej në prova dhe hetime për secilin rast dhe secilin deputet, por në rastin konkret, siç rezulton edhe nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të Etikës, provat u morën të mirëqena pa u verifikuar dhe përjashtimi ndodhi me një procedurë të shkurtër kohore.

Nga tabela rezulton gjithashtu se ndonëse incidentet më të mëdha në parlament kanë ndodhur në muajt nëntor dhe dhjetor 2023, penalizimet më të shumta janë bërë në seancat e tetorit 2023, pra kur reagimi i opozitës nuk ka qenë aq radikal. Më 6 tetor pati 8 penalizime, me 19 tetor 23 penalizime dhe më 31 tetor 5 penalizime, në total 36 penalizime, rekord historik i masave drastike ndaj deputetëve. Për shkak se procedura inicihet nga deputetë të tjerë, pra nga deputetët e mazhorancës, rezulton se me propozim të PS janë përjashtuar 55% e deputetëve të opozitës.



Duke i kalkuluar sipas grupeve politike, nga deputetët mbështetës të grupit Berisha janë përjashtuar 69% e grupit, nga deputetët mbështetës të grupit Bardhi janë përjashtuar 49% e deputetëve. Nga ana tjetër, nuk ka asnjë deputet të përjashtuar nga grupi i PS, PSD, apo nga partitë e vogla politike, përfshirë PDIU, PBDNJ, PAA, PR, etj, pavarësisht se disa raste reagimet personale të disa deputetëve, sidomos të PS kanë qenë në të njëjtin nivel jo etik dhe në shkelje të Rregullores sa edhe një pjesë e deputetëve moderatorë të përjashtuar nga opozita.

Tabela e përjashtimeve të deputetëve në vitet 2005–2023 tregon se vetëm viti 2023 përbën dallim thelbësor, me 85 përjashtime në total, ndërkohë që kuota e dytë më e lartë e përjashtimeve është shënuar në vitet 2016–2018 me nga 10 përjashtime, ose 2006 me 9 përjashtime. Duhet thënë se gjatë periudhës kur PS ishte në opozitë (2005–2013) ka pasur në total 23 përjashtime, ndërsa gjatë viteve të PS në qeveri kanë shënuar 62 përjashtime. Edhe legjislativat e PS-së kanë ndryshime, pasi në legjislativën e parë 2013–2017 ka pasur disa penalizime edhe për deputetë të mazhorancës, gjë që nuk ndodh më në legjislativën e fundit parlamentare.

## 7. KUVENDI, TRANSPARENCA DHE PROBLEMATIKA

Zbatimi i suksesshëm i legjislacionit për akses në dokumente publike është parakusht i domosdoshëm për një Kuvend transparent dhe bashkëpunues. Transparenca është parimi themelor mbi të cilin zhvillojnë veprimtarinë institucionet publike dhe faktor në përmirësimin e cilësisë së qeverisjes, forcimin e demokracisë dhe respektimin më të mirë të të drejtave të njeriut prandaj një parlament duhet të jetë i hapur dhe bashkëpunues. Transparenca parlamentare mundëson qytetarët që të informohen për veprimtarinë dhe punën e Kuvendit, të monitorojnë dhe të kontrollojnë veprimtarinë e tij, rrit besimin e publikut tek ky institucion, fuqizon pjesëmarrjen qytetare në procesin legjislativ dhe më gjerë, bën të mundur që qytetarët të kërkojnë llogari nga parlamentarët dhe siguron përfaqësim të interesave të qytetarëve.

Kuvendi ndonëse ka krijuar faqe të re interneti nuk ka mundur të krijojë ende një sistem të plotë dhe efikas transparence. Rezulton se vështirësia kryesore qëndron në gjetjen e materialeve. Problemet teknike janë të shumta dhe vështirësojnë kërkimin. Dokumente dhe të dhëna me rëndësi publike sikurse procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve (ky i fundit problem disavjeçar), CV e kandidaturave që zgjidhen /emërohen nga Kuvendi, të dhëna statistikore etj, ndryshe sa detyron Rregullorja e Kuvendit dhe aktet e brendshme, nuk janë ende online në dispozicion të publikut. Rendi i ditës për seancën plenare publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit me vonesë duke shkelur edhe minimumin e afatit prej jo më vonë se 48 orë përpara dhe me mungesë të raporteve të komisioneve parlamentare. Në shumë raste raportet janë publikuar vetëm pak orë përpara kalimit të projekt-aktit për shqyrtim në seancë plenare duke kufizuar ndjeshëm mundësinë e reagimit të ekspertëve dhe zërave të grupeve të interesit.

Kuvendi ka shënuar regres në drejtim të disa elementëve të transparencës, sidomos në aspektin statistikor. “Buletini statistikor 2021–2025” ofruar online nga Kuvendi me bilancin e akteve, votimeve, kohës së debatit, angazhimeve gjinore dhe politike, mbi natyrën e akteve dhe vendimmarrjet, broshura “Shpërndarja e deputetëve në organet e Kuvendit” apo Manuali “Mandatet Parlamentare 2021–2025”, ndonëse në fillim të legjislaturës përbënë zhvillim pozitiv dhe plotësuan një prej mangësive të legjislaturave të kaluara kanë mbetur të papërditësuara prej shumë kohësh. Gjithashtu Buletini Informativ, periodik dy-mujor me aktivitetin e seancës plenare apo Newsletter me aktivitetin e çdo seance plenare, të cilat përbënin gjithashtu risi dhe kontribut pozitiv në drejtim të konceptit “parlament i hapur”, nuk janë më në dispozicion të publikut. Risi është Buletini Informativ 6-mujor me aktivitetin e delegacioneve të përhershme/të përkohshme në organizatat ndërkombëtare.



Në faqen e internetit bëhet transmetimi i mbledhjeve të komisioneve dhe i seancave plenare, praktikë pozitive e cila në tërësi inkurajon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin legjislativ, duke forcuar kështu rolin e parlamentit si institucion.

- Me autorizimin e Byrosë<sup>19</sup>, Kuvendi publikon shpenzimet e kryera dhe ka filluar publikimin e pagave dhe përfitimeve të deputetëve. Të dhënat publikohen në formatin xls, program i cili është i lehtë për përdorim dhe i qasshëm nga qytetarët. Kjo është një arritje dhe tregon gatishmërinë e Kuvendit për të bërë transparencën e shpenzimeve duke forcuar besimin e publikut në organin ligjvënës.
- Ngjashëm, Kuvendi ka përgjegjësi të publikojë informacione gjithëpërfshirëse, të hollësishme, të qarta, të thjeshta, të mjaftueshme dhe të kuptueshme nga perspektiva e lexuesit sidomos në lidhje me zbatimin e kontratave të prokurimit<sup>20</sup>.
- Këto informacione duhet të jenë publike në tërësinë e tyre, duke përdorur terminologji të kuptueshme nga qytetarët për të bërë të mundur që informacioni të përcillet me efektivitet. Një informacion i tillë rekomandohet të publikohet në një format të lehtë për përdorim dhe në gjuhë të kuptueshme për qytetarët e zakonshëm, në mënyrë që të rritet transparenca fiskale.
- Edhe publikimi i peticioneve të qytetarëve si dhe i raporteve financiare përbëjnë një hap pozitiv në drejtim të përmirësimit të transparencës dhe forcimit të besimit të publikut në institucionin ligjvënës.

Megjithatë mbetet i nevojshëm edhe përditësimi e përmirësimi i faqes. Mirëmbajtja e faqes së internetit dhe përditësimi i rregullt i saj është aspekt jetik i transparencës parlamentare në botën e ndërlidhur moderne. Përdorimi i mekanizmave të kërkimit duhet të jenë sa më të lehta për qytetarët me qëllim gjetjen e informacionit në një kohë të shkurtër dhe të shpejtë duke krijuar baza të të dhënave dhe duke mundësuar kërkime të thjeshta dhe komplekse përmes përdorimit të metadatave të duhura. Informacioni parlamentar i publikuar përbën një aspekt kyç të veprimitarisë parlamentare dhe prezantimit të saj prandaj duhet të jetë i kuptueshëm dhe vizualisht më estetik, e për rrjedhojë edhe më i lexueshëm nga publiku dhe grupet e interesuara.

Parlamenti duhet të vërë në dispozicion informacione të mjaftueshme për të mundësuar qytetarët që të gjykojnë lidhur me integritetin dhe ndershmërinë e deputetëve individualë, duke përfshirë informacione lidhur me deklaratimet e pasurisë. Ngjashëm transparente duhet të bëhen edhe marrëdhëniet e deputetit me lobistët dhe organizatat e shoqërisë civile ose grupet e interesit. Këto detyrime burojnë nga Kodi i Sjelljes së Deputetit dispozitat e të cilit parashikojnë publikimin në internet të deklaratës së interesave privatë me të dhëna konfidenciale personale të

<sup>19</sup> Ky detyrim buron nga neni 11/6 i Rregullores së Kuvendit sipas të cilit "Byroja e Kuvendit me propozimin e Sekretariatit për Buxhetin, autorizon publikimin e shpenzimeve financiare të kryera nga Kuvendi në faqen zyrtare të internetit çdo dy muaj".

<sup>20</sup> Neni 7 i ligjit "Për të drejtën e informimit".

redaktuara (neni 16) në përputhje me legjislacionin në fuqi<sup>21</sup> si dhe publikimin e kontakteve të deputetit (neni 21) me lobistët, organizatat e shoqërisë civile, grupet e interesit për çështjet që kanë lidhje me pjesëmarrjen në procesin legjislativ. Kuvendi nuk ka arritur të krijojë një sistem transparent deklarimi, verifikimi dhe publikimi të elementëve të Kodit të Sjelljes, në mënyrë që të rrisë standardet e integritetit dhe besueshmërisë.

Përveç faqes zyrtare në internet, Kuvendi është i pranishëm edhe në rrjete sociale me llogarinë e tij në Facebook me një numër të konsiderueshëm ndjekësish (praktikë pozitive) duke mundësuar që veprimtaritë e Kuvendit të komunikohen në mënyrë efektive tek audienca më e re. Përmes kësaj platforme qytetarëve i ofrohet informacion për punën dhe zhvillimet në Kuvend. Prania në platformat e tjera sociale është një aspekt që mund të adresohet me qëllim të hapjes së sa më shumë kanaleve të komunikimit digjital dhe përfshirjes së sa më shumë audiencave në komunikimet e përditshme.

Një parlament llogaridhënës, transparent dhe i përgjegjshëm ka rëndësi të madhe për demokracinë për shkak të përgjegjësisë kushtetuese që ka në miratimin e ligjeve, kontrollin dhe mbikëqyrjen e performancës së ekzekutivit dhe institucioneve të tjera kushtetuese/të krijuara me ligj, zgjedhjen e funksionarëve të lartë të shtetit si dhe në përfaqësimin e qytetarëve dhe pasqyrimin e interesave të tyre.

---

<sup>21</sup> Legjislacionin për të drejtën e informimit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe legjislacionin përkatës për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe të detyrimeve financiare.

**Aneks 1.****Vendet vakante në ushtrimin e funksionit zgjedhor nga Kuvendi shtator-dhjetor 2023<sup>22</sup>**

Institucioni kushtetues/ose i krijuar me ligj	Data e mbarimit të mandatit	Shpallja e vakancës nga propozuesi	Afati shpalljes së vakancës sipas kuadrit ligjor
Këshilli i Lartë Gjyqësor (Mandat 5 vjeçar)	20.12.2023 (Referuar konstituimit)	Shpallur më <a href="#">19.07.2023</a> nga Kuvendi	Jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit (Sipas ligjit organik)
Këshilli i Lartë Gjyqësor (Mandat 5 vjeçar)	20.12.2023 (Referuar konstituimit)	Shpallur më <a href="#">19.07.2023</a>	Jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit (Sipas ligjit organik)
Këshilli i Lartë Gjyqësor (Mandat 5 vjeçar)	20.12.2023 (Referuar konstituimit)	Shpallur më <a href="#">19.07.2023</a>	Jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit (Sipas ligjit organik)
Këshilli i Lartë i Prokurorisë (Mandat 5 vjeçar)	19.12.2023 (Referuar konstituimit)	Shpallur më <a href="#">19.07.2023</a>	Jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit (Sipas ligjit organik)
Këshilli i Lartë i Prokurorisë (Mandat 5 vjeçar)	19.12.2023 (Referuar konstituimit)	Shpallur më <a href="#">19.07.2023</a>	Jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit (Sipas ligjit organik)
Këshilli i Lartë i Prokurorisë (Mandat 5 vjeçar)	19.12.2023 (Referuar konstituimit)	Shpallur më <a href="#">19.07.2023</a>	Jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit (Sipas ligjit organik)
Enti Rregullator i Energjisë (Mandat 5 vjeçar)	13.12.2023	Shpallur më <a href="#">15.9.2023</a>	3 muaj përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të vjetër (Sipas ligjit organik)
Enti Rregullator i Energjisë (Mandat 5 vjeçar)	26.02.2024	Nuk është shpallur ende nga Kuvendi	3 muaj përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të vjetër (Sipas ligjit organik)
Enti Rregullator i Energjisë (Mandat 5 vjeçar)	26.02.2024	Nuk është shpallur ende nga Kuvendi	3 muaj përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të vjetër (Sipas ligjit organik)
Avokati i Popullit, (Mandat 5 vjeçar)	22.05.2022	Shpallur më <a href="#">30.03.2022</a> , <a href="#">rishpallur me 31.01.2023</a>	45–30 ditë para mbarimit të mandatit të anëtarit të vjetër (Sipas Rregullores së Kuvendit)

<sup>22</sup> Të dhënat i referohen faqes së Kuvendit në internet.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ( <i>Mandat 5 vjeçar</i> )	05.04.2023	Shpallur më <a href="#">14.02.2023</a>	45–30 ditë para mbarimit të mandatit të anëtarit të vjetër (Sipas Rregullores së Kuvendit)
Komisioni Konkurrencës ( <i>Mandat 5 vjeçar</i> )	25.01.2023	<a href="#">Shpallur më 12.12.2022</a> , <a href="#">rishpallur me 11.07.2023</a>	45–30 ditë para mbarimit të mandatit të anëtarit të vjetër (Sipas Rregullores së Kuvendit)
Këshilli i Statistikave ( <i>Mandat 5 vjeçar</i> )	Dorëhequr më 15.07.2021	<a href="#">Shpallur më 29.05.2023</a> Këshilli i Ministrave	Pa përcaktim ligjor
Komisioner i Avokatit të Popullit në Seksionin për organet e administrates ( <i>Mandat 4 vjeçar</i> )	Dorëhequr më 11.11.2022	Shpallur më <a href="#">15.12.2022</a> , <a href="#">rishpallur 20.12.2022</a>	Brenda 10 ditëve nga krijimi i vakancës. (Sipas ligjit organik)
Komisioner i Avokatit të Popullit në Seksionin e Përgjithshëm ( <i>Mandat 4 vjeçar</i> )	26.02.2023	Shpallur më <a href="#">20.12.2022</a>	3 muaj përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të vjetër (Sipas ligjit organik)
Komisioner i Avokatit të Popullit në Seksionin e Policisë, ( <i>Mandat 4 vjeçar</i> )	26.02.2023	Shpallur më <a href="#">20.12.2022</a>	3 muaj përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të vjetër (Sipas ligjit organik)
Këshilli Drejtues RTSH ( <i>Mandat 5 vjeçar</i> )	Dorëheqje 31.08.2021	Shpallur më <a href="#">03.10.2022</a> , <a href="#">rishpallur me 15.11.2022</a>	Brenda 30 ditëve nga krijimi i një vendi vakant. (Sipas ligjit organik)
Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojava të Komunizmit në Shqipëri ( <i>Mandat 5 vjeçar</i> )	26.02.2023	Shpallur më 31.01.2023	Pa përcaktim ligjor
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ( <i>Mandat 5 vjeçar</i> )	Dorëhequr më 11.09.2023	Shpallur më <a href="#">20.09.2023</a> , Rishpallur më <a href="#">06.10.2023</a>	Pa përcaktim ligjor
Komisioni i Prokurimit Publik ( <i>Mandat 5 vjeçar</i> )	Dorëhequr në shkurt 2021	Shpallur më <a href="#">01.02.2022</a>	Jo më vonë se 30 ditë nga dita e përfundimit të parakohshëm të mandatit (Sipas ligjit organik)

**Aneks 2.****Ecuria e shqyrtimit të projektligjeve në Kuvend gjatë periudhës shtator-dhjetor 2023<sup>23</sup>**

Projektligji	Depozitimi në Kuvend	Shqyrtimi në komisione	Në seancë plenare
<a href="#">Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi, për sigurimet shoqërore".</a>	20.06.2023	11.09.2023 – KPÇSSH 11.09.2023 – KÇLAPDNJ 06.09.2023 – KPJ	14.09.2023
<a href="#">Projektligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar (EPA) për themelimin e regjistrit të dëmeve të shkaktuara nga agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës".</a>	30.06.2023	11.09.2023 – KPJ 12.09.2023 – KEF 11.09.2023 – KÇLAPDNJ	14.09.2023
<a href="#">Projektligji "Për miratimin e rezolutës nr.463 (2022), të Bordit Drejtues të CEB, "Rritja e kapitalit të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB)".</a>	21.07.2023	06.09.2023 – KPJ 11.09.2023 – KÇLAPDNJ 12.09.2023 – KEF	14.09.2023
<a href="#">Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë, për eliminimin e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin dhe shmangien e evazionit tatimor".</a>	27.07.2023	11.09.2023 – KÇLAPDNJ 12.09.2023 – KEF	14.09.2023
<a href="#">Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2022 për projektin "Ekonomia qarkulluese për zhvillimin e qëndrueshëm urban në Shqipëri".</a>	28.08.2023	11.09.2023 – KPJ 12.09.2023 – KEF 12.09.2023 – KÇLAPDNJ 12.09.2023 – KVPTM	14.09.2023
<a href="#">Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.74/2014, "Për armët", të ndryshuar".</a>	10.03.2023	13.07.2023 – KÇE 19.06.2023 – KÇLAPDNJ 17.07.2023 – KSK	14.09.2023
<a href="#">Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar".</a>	07.07.2023	12.09.2023 – KÇLAPDNJ 11.09.2023 – KEF	Planifikuar për 14.09.2023 (shtyhet pa vendim Kuvendi)
<a href="#">Projektligji "Për fondet e pensionit privat".</a>	19.12.2022	06.07.2023 – KÇE 10.07.2023 – KÇLAPDNJ 11.04.2023 – KPÇSSH 19.09.2023 – KEF	21.09.2023
<a href="#">Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 113/2020, "Për shtetësinë".</a>	20.04.2023	24.05.2023 dhe 31.05.2023 – KPJ 11.07.2023 – KÇLAPDNJ 17.07.2023 – KSK	21.09.2023

<sup>23</sup> Të dhënat i referohen faqes së Kuvendit në internet.

		13.07.2023 – KÇE	
<a href="#">Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit"</a>	21.07.2023	19.09.2023 – KÇLAPDNJ 18.09.2023 – KEF 18.09.2023 – KSK	21.09.2023
<a href="#">Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"</a>	21.07.2023	18.09.2023 – KÇLAPDNJ 25.09.2023 – KPÇSSH	05.10.2023
<a href="#">Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin "Ndërtimi i urave të qëndrueshme, duke përdorur qasjen e programit me shumë faza"</a>	31.08.2023	02.10.2023 – KPJ 03.10.2023 – KEF 04.10.2023 – KÇLAPDNJ	05.10.2023
<a href="#">Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë për vitin 2020, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA II), ratifikuar me ligjin nr. 3/2022"</a>	31.08.2023	02.10.2023 – KPJ 02.10.2023 – KÇE 03.10.2023 – KEF 02.10.2023 – KÇLAPDNJ	05.10.2023
<a href="#">Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 75/2014, "Për shërbimin privat të sigurisë fizike"</a>	10.02.2023	13.09.2023 – KÇLAPDNJ 12.09.2023 – KSK 19.09.2023 – KSK 03.10.2023 – KSK 10.10.2023 – KSK	Parashikuar në rendin e ditës më 19.10.2023
<a href="#">Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për avokaturën e shtetit", të ndryshuar"</a>	06.07.2023	03.10.2023 – KÇE 12.09.2023 – KÇLAPDNJ 04.10.2023 – KÇLAPDNJ	Parashikuar në rendin e ditës më 19.10.2023
<a href="#">Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë"</a>	27.07.2023	11.09.2023 – KPJ 04.10.2023 – KÇE 10.10.2023 – KEF 02.10.2023 – KÇLAPDNJ	Parashikuar në rendin e ditës më 19.10.2023
<a href="#">Akt normativ nr. 5, datë 18.10.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023"</a>	23.10.2023	31.10.2023 – KEF	02.11.2023
<a href="#">Projektligji "Për një ndryshim në ligjin nr.10 083, datë 23.2.2009, "Për miratimin e kontratës së koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si autoritet kontraktues, dhe EVN AG, Statkraf t AS dhe Devoll Hydropoëer, sh.a., si bashkëkoncesionarë për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë"</a>	14.09.2023	17.10.2023 – KÇLAPDNJ 18.10.2023 – KVPTM 31.10.2023 – KEF	02.11.2023
<a href="#">Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi) dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim (huadhënësi), për financimin e projektit "Politika</a>	19.09.2023	17.10.2023 – KVPTM 17.10.2023 – KÇLAPDNJ 17.10.2023 – KPJ	02.11.2023

<a href="#">për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri – faza II”</a> .		31.10.2023 – KEF	
<a href="#">Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.</a>	29.09.2023	17.10.2023 – KÇLAPDNJ 18.10.2023 – KSK	02.11.2023
<a href="#">Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KFË Frankfurt AM MAIN (KFË), për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri – faza II”</a>	29.09.2023	17.10.2023 – KVPTM 17.10.2023 – KPJ 31.10.2023 – KEF 17.10.2023 – KÇLAPDNJ	02.11.2023
<a href="#">Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, nga njëra anë, dhe Bashkimit Evropian, nga ana tjetër, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit “Evropa Digjitale” (2021–2027)”.</a>	05.10.2023	31.10.2023 – KVPTM 30.10.2023 – KEF 31.10.2023 – KÇLAPDNJ 31.01.2023 – KPJ 31.01.2023 – KÇE	02.11.2023
<a href="#">Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim notash, të marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, ratifikuar me ligjin nr. 31/2021”.</a>	12.09.2023	17.10.2023 – KEF 17.10.2023 – KVPTM 17.10.2023 – KPJ 17.10.2023 – KÇE 16.10.2023 – KÇLAPDNJ	02.11.2023
<a href="#">Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë, për mbrojtjen shoqërore”.</a>	14.09.2023	17.10.2023 – KPJ 17.10.2023 – KÇE 30.10.2023 – KPÇSSH 31.10.2023 – KEF 16.10.2023 – KÇLAPDNJ	02.11.2023
<a href="#">Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër – hua për politikën e zhvillimit”.</a>	19.10.2023	07.11.2023 – KPJ 07.11.2023 – KEF 07.11.2023 – KVPTM 06.11.2023 – KÇLAPDNJ	09.11.2023
<a href="#">Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.</a> (Nismë deputeti)	09.03.2022	03.10.2023 – KÇLAPDNJ 30.10.2023 – KEF	09.11.2023
<a href="#">Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar”.</a> (Nismë deputeti)	09.12.2022	31.01.2023 – KVPTM	09.11.2023
<a href="#">Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.</a> (Nismë deputeti)	09.12.2022	18.10.2023 – KÇLAPDNJ 30.10.2023 – KEF	09.11.2023
<a href="#">Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01 .1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”.</a> (Nismë deputeti)	18.03.2022	03.10.2023, 10.10.2023 dhe 18.10.2023 – KSK 12.04.2023 dhe 18.10.2023 – KÇLAPDNJ	09.11.2023

<a href="#">Projektligji "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar""</a> . (Nismë deputeti)	18.11.2022	Mungon raporti i KÇLAPDNJ në faqen e Kuvendit	09.11.2023
<a href="#">Projektligji "Për disa shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar""</a> . (Nismë deputeti)	07.02.2023	12.04.2023 dhe 18.10.2023 – KÇLAPDNJ	09.11.2023
<a href="#">Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"</a> .	31.10.2023	14.11.2023 – KVPTM 06.11.2023 – KEF 13.11.2023 – KÇE  23.11.2023 – KVPTM 01.12.2023 – KEF	20.11.2023 (në parim) 07.12.2023 (nen/nen dhe tërësi)
<a href="#">Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar""</a> .	31.10.2023	09.11.2023 – KEF 13.11.2023 – KÇE 01.12.2023 – KEF	20.11.2023 (në parim) 07.12.2023 (nen/nen dhe tërësi)
<a href="#">Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare""</a> , të ndryshuar"	31.10.2023	14.11.2023 – KVPTM 06.11.2023 – KÇLAPDNJ 07.11.2023 – KEF 13.11.2023 – KÇE 23.11.2023 – KVPTM 01.12.2023 – KEF	20.11.2023 (në parim)  07.12.2023 (nen/nen dhe tërësi)
<a href="#">Projektligji "Për disa shtesa në ligjin nr.92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë""</a> , të ndryshuar""	31.10.2023	14.11.2023 – KVPTM 06.11.2023 – KEF 13.11.2023 – KÇE 23.11.2023 – KVPTM 13.12.2023 – KEF	20.11.2023 (në parim) 21.12.2023 (nen/nen dhe tërësi)
<a href="#">Projektligji "Për buxhetin e vitit 2024"</a>	31.10.2023	07.11.2023 – KPJ 14.11.2023 – KVPTM 16.11.2023 – KSK 16.11.2023 – KEF 06.11.2023 – KÇLAPDNJ 15.11.2023 – KPÇSSH 14.11.2023 – KEMIP 13.11.2023 – KÇE 23.11.2023 – KVPTM 24.11.2023 – KÇLAPDNJ 01.12.2023 – KEF	20.11.2023 (në parim)  07.12.2023 (nen/nen dhe tërësi)
<a href="#">Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit "Qëndrueshmëria ndaj klimës dhe zhvillimit të bujqësisë""</a>	02.11.2023	05.12.2023 – KPJ 12.12.2023 – KEF 05.12.2023 – KVPTM	14.12.2023



<a href="#">Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7975, datë 26.7.1995, "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope", të ndryshuar"</a>	06.07.2023	03.10.2023 – KSK 03.10.2023 – KÇE 03.10.2023 – KÇLAPDNJ 12.12.2023 – KPÇSSH	14.12.2023
<a href="#">Projektligji "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike"</a>	27.10.2023	04.12.2023 – KÇLAPDNJ 12.12.2023 – KEF 12.12.2023 – KÇE	14.12.2023
<a href="#">Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë"</a>	16.11.2023	05.12.2023 – KÇLAPDNJ 06.12.2023 – KSK 13.12.2023 – KEF 12.12.2023 – KÇE	14.12.2023
<a href="#">Projektligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Unionin Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës (IUCN)"</a>	26.10.2023	05.12.2023 – KPJ 12.12.2023 – KÇLAPDNJ 14.12.2023 – KEF 19.12.2023 – KVPTM	21.12.2023
<a href="#">Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së nivelit të lartë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për hartat treguese të rrjetit transevropian të transportit në Shqipëri"</a>	05.10.2023	07.11.2023 – KPJ 06.11.2023 – KÇLAPDNJ 12.12.2023 – KÇE 19.12.2023 – KVPTM	21.12.2023
<a href="#">Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2020 për projektin "Programi i performancës dhe investimeve në sektorin e ujërave, pjesa e dytë (Infrastruktura komunale, faza V, pjesa II)"</a>	16.11.2023	11.12.2023 – KPJ 11.12.2023 – KÇLAPDNJ 14.12.2023 – KEF 13.12.2023 – KVPTM	21.12.2023
<a href="#">Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit"</a>	30.11.2023	19.12.2023 – KÇLAPDNJ	21.12.2023

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë  
Instituti i Studimeve Politike  
Parlamenti që (s)duam : Bilanci parlamentar 2023. Gjetje dhe  
rekomandime / Instituti i Studimeve Politike ; editor Afrim  
Krasniqi. – Tiranë : Instituti i Studimeve Politike, 2024.  
... f. ; ... cm.  
ISBN 9789928475671  
1.Parlamenti Shqiptar 2.Monitorime 3.Raporte 4.Shqipëri  
328(496.5) "2023" (047)



**INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE**

Web: [www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)

E-mail: [contactaips@isp.com.al](mailto:contactaips@isp.com.al)

Facebook: [Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies](#)

Adresa: Rr. "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89, K.3, Ap. 16, Tiranë